



Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJET LOKALE
15 tetor dhe 29 tetor 2017

Raporti përfundimtar i
Misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it



Varshavë
19 janar 2018

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE MIRËNJOHJE	4
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE	5
V.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	7
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	10
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	12
VIII.	AMBIENTI I FUSHATËS	13
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS	18
X.	MEDIAT	20
	A. AMBIENTI MEDIATIK.....	20
	B. KORNIZA LIGJORE.....	20
	C. KONSTATIMET E OSBE/ODIHR-IT NGA MONITORIMI I MEDIAVE.....	21
XI.	ANKESAT DHE APELIMET	23
XII.	VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË	26
XIII.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	26
XIV.	DITA E ZGJEDHJEVE (RRETHI I PARË)	27
	A. HAPJA DHE VOTIMI.....	27
	B. NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE	28
XV.	DITA E ZGJEDHJEVE (RRETHI I DYTË)	29
	A. HAPJA DHE VOTIMI.....	30
	B. NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE	30
XVI.	ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	31
	A. ZHVILLIMET POLITIKE	31
	B. ANKESAT DHE APELIMET	32
XVII.	REKOMANDIMET	34
	A. REKOMANDIMET PRIORITARE	34
	B. REKOMANDIMET E TJERA.....	35
	ANEKSI I: REZULTATET ZGJEDHORE	39
	ANEKSI II: LISTA E VËZHguesVE TË MISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE	45
	PËR OSBE/ODIHR-IN	52

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
ZGJEDHJET KOMUNALE
15 tetor dhe 29 tetor 2017

Raporti përfundimtar i Misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës zyrtare nga Ministria për Punë të Jashtme për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të datës 15 tetor të vitit 2017, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) më 13 shtator e krijoi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ). Misioni mbeti në vend për ta ndjekur rrethin e dytë të zgjedhjeve më 29 tetor. Misioni vlerësoi se a u zhvilluan zgjedhjet në përputhje me angazhimet e OSBE-së, obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjisllacionin e vendit. Për rrethin e parë të zgjedhjeve më 15 tetor, MVZ-së së OSBE/ODIHR-it iu bashkua edhe një delegacion i Kongresit të autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës për ta formuar Misionin ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve (MNVZ). Çdo institucion i përfshirë në këtë MNVZ e ka miratuar Deklaratën e parimeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve të vitit 2005.

Deklarata për gjetjet dhe përfundimet paraprake e lëshuar nga MNVZ-ja pas rrethit të parë nxori përfundimin se zgjedhjet lokale “kontribuan për përforcimin e besimit në procesin demokratik. Zgjedhjet u mbajtën në një ambient konkurrues, ku kandidatët, në përgjithësi, kishin mundësi të bëjnë fushatë pa kufizime dhe ku liritë themelore, në përgjithësi, u respektuan. Megjithatë, gjatë periudhës parazgjedhore kishte pretendime të besueshme për blerje të votave, presion mbi votuesit dhe pati raste të izoluara të dhunës. Në përgjithësi, mediat e monitoruara ofruan mbulim të paanshëm të garuesve dhe e lehtësuan mundësinë për debat politik. Përkundër sfidave organizative, administrata zgjedhore, në përgjithësi, siguroi që votuesit ta kenë mundësinë për ta ushtruar të drejtën e tyre të votës”.

Deklarata për gjetjet dhe përfundimet paraprake e lëshuar nga MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it pas rrethit të dytë nxori përfundimin se “zgjedhjet për kryetarë të komunave ishin konkurrencte dhe respektimi i lirive themelore kontribuoi për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Fushata ishte e shkurtër dhe e qetë, me ç’rast partitë garuan për të fituar mbështetje jashtë bazave të tyre tradicionale, edhe pse herë pas here përdorën retorikë agresive. U raportuan raste të izoluara të keqpërdorimit të burimeve administrative dhe të blerjes së votave. Mediat vazhduan të ofrojnë mbulim të balancuar të garuesve, mirëpo kjo u zbeh nga video-klipet negative të fushatës. Dita e zgjedhjeve, në përgjithësi, u menaxhua në mënyrë profesionale, edhe pse puna e anëtarëve të Këshillave zgjedhorë gjatë numërimit të votave ka mundur të përmirësohet”.

Korniza ligjore i garanton të drejtat dhe liritë themelore dhe në përgjithësi ofron një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Edhe pse me ndryshimet e bëra në vitet në Kodin zgjedhor (KZ) u trajtuan një numër i rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës, megjithatë kanë mbetur disa mangësi, duke përfshirë kufizimet e panevojshme për regjistrimin e kandidatëve të pavarur, të drejtat e kufizuara për mjete juridike dhe dispozitat e pamjaftueshme për rrethin e dytë. Poashtu, ndryshimi i vonshëm i KZ-së, që kishte të bëjë me ndryshimin e përbërjes së Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), e sfiduan stabilitetin e procesit zgjedhor, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

KSHZ-ja arriti t'i administrojë të dyja rrethet zgjedhore, mirëpo funksionoi e ndarë sipas vijave partiake. Mosmarrëveshjet e saj të brendshme rezultuan me tejkalim të afateve kohore dhe disa nga vendimet e saj ishin në kundërshtim me ligjin. KSHZ-ja nuk e planifikoi në mënyrë adekuate rrethin e dytë të zgjedhjeve, nuk arriti të zbatojë program gjithëpërfshirës për edukimin e votuesve dhe në përgjithësi, kishte mungesë të transparencës së mirëfilltë. Në përgjithësi, komisionet e nivelit të mesëm i kryen detyrat e tyre në mënyrë efektive dhe disa prej tyre ndërmorën masa plotësuese për ta përmirësuar transparencën dhe besimin e palëve të interesuara në administrimin e zgjedhjeve. Pozitivisht, u ndërmorën disa hapa për ta lehtësuar të drejtën e votës për personat me pengesa.

Për këto zgjedhje ishin regjistruar rreth 1.8 milionë votues. Gjatë verifikimit onlajn dhe personal të listave zgjedhore u kërkuar vetëm një numër i vogël i ndryshimeve, që ishte shenjë e besimit të shtuar në saktësinë e listës. Megjithatë, votuesit, të cilëve u kishte kaluar ose do t'u kalonte afati i vlefshmërisë së dokumenteve para zgjedhjeve, ishin hequr nga lista, dhe me këtë u ishte pamundësuar e drejta e votës. Kjo poashtu vlente edhe për të burgosurit të cilët nuk kishin mundësi t'i rinovojnë dokumentet e tyre të identifikimit. Poashtu, ligji nuk parasheh përditësim të listave ndërmjet dy rretheve zgjedhore, kështu që votuesit që i mbushën 18 vjet gjatë kësaj periudhe nuk kishin mundësi ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Ligji poashtu e kufizon të drejtën e votës për personat që janë shpallur ligjërisht të paaftë për shkak të paaftësisë, që është në kundërshtim me obligimet ndërkombëtare.

Pas një procesi inkluziv të regjistrimit, 19 parti politike dhe koalicione, si dhe 65 grupe votuesish, paraqitën gjithsej 258 kandidatë për kryetarë të komunave dhe 370 lista me kandidatë për këshillat komunalë. Pesë për qind e listave me kandidatë nuk i plotësuan kërkesat për kuotat e gjinive, megjithatë u regjistruan. Votuesve iu ofruan një varg mundësish për të zgjedhur, dhe në shumë komuna pati gara të ngushta ndërmjet garuesve.

Fushata u zhvillua në një ambient ku liritë themelore për tubim dhe liri të shprehjes u respektuan në përgjithësi. Megjithatë, kishte disa incidente të izoluara, të motivuara politikisht dhe vazhduan pretendimet e besueshme për blerje të votave dhe presion mbi votuesit. Strategjitë për fushatat lokale u përgatitën në nivel qendror, ndërsa u ndryshuan para rrethit të dytë për t'i synuar votuesit e papërcaktuar. U vërejt keqpërdorim i funksioneve të pushtetit lokal dhe i burimeve administrative në disa komuna dhe u shprehën shqetësime kur kryeministri haptazi premtoi mbështetje qeveritare për komunat me kryetarë nga radhët e koalicionit në pushtet. Ky veprim e dëmtoi parimin e ndarjes së shtetit nga partia, që është paraparë me përkushtimet e OSBE-së.

Rregullat për financimin e fushatës që u përmirësuan gjatë viteve të fundit, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe Këshillit të Evropës, në përgjithësi ofrojnë terren të barabartë për garë dhe një shkallë transparence. Megjithatë kjo e fundit nuk u realizua në tërësi për shkak të mosdorëzimit në kohë të raporteve, mungesës së kërkesës ligjore për revizion të raporteve të përkohshme për financim të fushatës dhe dispozitave për zbatim të tyre, si dhe për shkak të kompetencave të kufizuara për mbikëqyrje nga Enti shtetëror për revizion (ESHR). Kjo e zvogëloi mundësinë e votuesve për të bërë zgjedhje të informuar.

Korniza ligjore përcakton mbulim të balancuar dhe të paanshëm të fushatës nga mediat. Transmetuesi publik u ofroi të gjithë kandidatëve minutazh për emetim falas, mirëpo shumë pak prej tyre e shfrytëzuan atë. Dy partitë më të madhe dominuan në reklamimin me pagesë në mediat private. Debatet televizive ishin të organizuara mirë, megjithatë jo të gjithë kandidatët e ftuar morën pjesë në to. Efektiviteti i shqyrtimit gjyqësor të shkeljeve të bëra nga mediat u dëmtua nga gjykatat që nuk i respektuan afatet ligjore dhe që shqiptuan dënime më të ulëta se sa ato që janë paraparë me ligj.

Dispozitat për ta avancuar barazinë gjinore nuk u respektuan gjithmonë dhe promovimi i pjesëmarrjes së grave në jetën publike nuk u trajtua në fushatë. Kuota për përfaqësim gjinor prej 30 për qind u respektua në përbërjen e KSHZ-së, mirëpo nuk u zbatua në mënyrë konsekuente në nivelet më të ulëta të administratës zgjedhore. Katërmbëdhjetë për qind e të gjitha listave u udhëhoqën nga gratë, ndërsa nga të gjithë kandidatët për kryetarë të komunave, vetëm gjashtë për qind ishin gra.

Marrëdhëniet ndëretnike luajtën rol në këto zgjedhje. Edhe pse disa parti kërkuan vota përtej kufijve etnikë, shumica e listave me kandidatë e pasqyruan përbërjen etnike të komunës së caktuar. U vërejt retorikë konfrontuese brenda bashkësisë së njëjtë në komunat ku partitë të cilat i takojnë koalicionit të njëjtë në nivel nacional garonin njëra me tjetrën në nivel lokal. Një incident serioz në lidhje me zgjedhjet, që e shpalosi shkallën e lartë të polarizimit në bashkësinë rome, ndodhi në lagjen Shuto Orizare në Shkup.

Korniza ligjore nuk ofron plotësisht mjete efektive ligjore për kontestet zgjedhore, me ç'rast shumica e vendimeve nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së. KSHZ-ja pranoi vetëm disa ankesa deri në ditën para mbajtjes së zgjedhjeve. Edhe pse kishte pretendime të shumta për praktika korruptive në lidhje me zgjedhjet anembanë vendit, shumë pak ankesa u parashtruan para organeve kompetente. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it e potencuan mungesën e besimit në aftësinë e administratës zgjedhore dhe të gjykatave për t'i shqyrtuar rastet në mënyrë të pavarur.

Qasja e vëzhguesve qytetarë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor kontribuoi për të pasur transparencë dhe ofroi vlerësim jopartiak të zgjedhjeve. Gjithsej rreth 3.000 vëzhgues qytetarë u akredituan për t'i ndjekur procedurat në ditën e votimit. Poashtu, në disa komuna shoqëria qytetare bëri përpjekje për të mundësuar përfshirje më të madhe të personave me pengesa dhe të komuniteteve të rrezikuara në procesin zgjedhor.

Të dyja ditët e zgjedhjeve ishin të organizuara mirë dhe kaluan në mënyrë të rregullt në pjesën më të madhe të vendit. Megjithatë, u vërejtën disa parregullsi që përsëriten, duke përfshirë votimin familjar/grupor dhe komprometimin e fshehtësisë së votës. Parregullsitë procedurale që u vërejtën gjatë numërimit të votave e zvogëluan vlerësimin e përgjithshëm pozitiv në të dyja rrethet. Nxjerrja e rezultateve u përmirësua në rrethin e dytë. Poashtu, pas rrethit të dytë, publikimi i menjëhershëm onlajn i rezultateve sipas vendvotimeve e përmirësoi transparencën.

KSHZ-ja pranoi shumë ankesa ku pretendoheshin parregullsi në ditën e zgjedhjeve të cilat mund të paraqisnin bazë për anulim. Në të dyja rrethet zgjedhore u refuzuan të gjitha ankesat. Rastet u vendosën në mbledhje të hapura, ndërsa ankesat dhe vendimet u publikuan onlajn, gjë që kontribuoi për transparencë. Megjithatë, mënyra në të cilën u trajtuan shumë ankesa e rrezikoi sundimin e ligjit dhe rregullsinë e procesit, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së, duke i lënë rastet që kishin bazë pa mjet efektiv ligjor. Gjykata Administrative i vërtetoi të gjitha vendimet e KSHZ-së për të cilat u parashtruan ankesa, përveç njërit.

Në përgjithësi, zgjedhjet komunale të vitit 2017 u perceptuan si një hap i rëndësishëm për ndërtimin e kredibilitetit të qeverisë së re dhe kontribuan në përforcimin e besimit në procesin demokratik. KSHZ-ja i konfirmoi rezultatet e zgjedhjeve më 14 nëntor, megjithatë ato nuk u pranuan nga i gjithë spektri politik. Koalicioni qeveritar e mbështeti procesin, mirëpo partia kryesore opozitare refuzoi t'i pranojë rezultatet për shkak të shkeljeve të shumta të pretenduara, mirëpo të pambështetura, gjatë gjithë procesit zgjedhor. Megjithatë, në të gjitha komunat u bë dorëzim paqësor i pushtetit.

Ky raport ofron një numër rekomandimesh për t'i mbështetur përpjekjet për t'i afruar zgjedhjet në vendin nikoqir që të jenë në përputhje me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare kanë të bëjnë me nevojën për reforma inkluzive dhe në kohë ligjore, të drejta të barabarta të votës, transparencë dhe llogaridhënie të administratës zgjedhore, masa për të siguruar terren të barabartë në fushatë, transparencë në financimin e fushatës dhe të drejtën për mjete efektive ligjore. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm për t'u ndihmuar autoriteteve që ta përmirësojnë kornizën dhe procesin zgjedhor, si dhe për të trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Në përgjigje të ftesës zyrtare nga Ministria për Punë të Jashtme, Zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) e krijoi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 15 tetorit. Misioni mbeti në vend për rrethin e dytë të zgjedhjeve me 29 tetor. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, e udhëhequr nga Ambasadorja Audrey Glover përfshinte 17 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin.

Për ditën e zgjedhjeve më 15 tetor, MVZ-së së OSBE/ODIHR-it iu bashkua delegacioni 13-anëtarësh nga Kongresi i autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi) nga 12 vende anëtare të Këshillit të Evropës për ta formuar Misionin ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve (MNVZ). Çdo institucion i përfshirë në këtë MNVZ e ka miratuar Deklaratën e Parimeve për vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve të vitit 2005. Gjithsej u shpërndanë 208 vëzhgues, ndërsa vëzhguesit u siguruan nga 31 vende pjesëmarrëse të OSBE-së. Për rrethin e dytë që u mbajt më 29 tetor, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it përfshinte 17 ekspertë në kryeqytet, 17 vëzhgues afatgjatë dhe 88 vëzhgues afatshkurtër të shpërndarë në mbarë vendin. Vëzhguesit u siguruan nga 25 vende pjesëmarrëse të OSBE-së.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it e vlerësoi pajtueshmërinë e procesit zgjedhor me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin nacional. Ky raport përfundimtar pason pas Deklaratave për gjetjet dhe përfundimet paraprake për rrethin e parë dhe të dytë, të cilat u publikuan në konferencat për shtyp në Shkup më 16 tetor dhe 30 tetor, respektivisht.²

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dëshiron t'i falënderojë autoritetet për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) dhe autoritetet e tjera për ndihmën e tyre. Ajo poashtu dëshiron t'u shprehë falënderim edhe shoqërisë civile, partive politike, mediave dhe institucioneve të tjera shtetërore, për këmbimin e pikëpamjeve të tyre me misionin, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2016, formimi i qeverisë u paraqit si sfida. Në shkurt të vitit 2017, Partia Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), e cila fitoi numrin më të madh të deputetëve në parlament, nuk arriti marrëveshje me partnerin e saj tradicional të koalicionit, Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI). BDI-ja dhe partitë e tjera të shqiptarëve etnikë e

² Shih [raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë](#).

mbështetën Lidhjen Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM), mirëpo kryetari i shtetit nuk ua dha atyre mandatin për të formuar qeveri.

Kriza u përshkallëzua më 27 prill, kur pas disa përpjekjeve të pasuksesshme, një shqiptar etnik u zgjodh për kryetar të Kuvendit. Kjo gjë shkaktoi konfrontim në Kuvend dhe rezultoi me sulm fizik ndaj deputetëve, duke përfshirë edhe ndaj anëtarëve të lartë të LSDM-së dhe të Aleancës për Shqiptarët (ASH). Kriza politike u qetësua vetëm pasi kryetari i shtetit ia dha mandatin LSDM-së që të formojë qeveri, e cila u krijua më 31 maj, pas një vonese gjashtëmuajore. Për pasojë, zgjedhjet lokale u shtynë deri më 15 tetor. Në korrik qeveria miratoi reforma ekonomike, gjyqësore dhe politike dhe një plan për t'i trajtuar shqetësimet për keqpërdorimin e burimeve administrative, presionin ndaj nëpunësve publikë, mbulimin jo të balancuar mediatik dhe mungesën e transparencës së administratës zgjedhore.

Aspiratat shumëvjeçare të vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) dhe në NATO, përqindja në vazhdimësi e lartë e papunësisë dhe niveli i lartë i emigrimit e formuan sfondin e këtyre zgjedhjeve. Posaçërisht, mënyra e mbajtjes së zgjedhjeve lokale nga shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it u perceptua se ka ndikim në proceset e integritetit në BE dhe NATO, që janë në zhvillim e sipër.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE

Zgjedhjet lokale mbahen çdo katër vjet për t'i zgjedhur kryetarët e komunave dhe këshillat komunalë në 80 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Këshilltarët zgjidhen me përfaqësim proporcional nëpërmjet listave të mbyllura me kandidatë.³ Kryetarët e komunave zgjidhen sipas sistemit të shumicës në dy rrethe zgjedhore. Në qoftë se asnjë kandidat për kryetar komune nuk fiton më shumë se 50 për qind të të gjitha votave të hedhura në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë pas dy javësh. Për rrethin e parë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave nevojitet pjesëmarrje e një të tretës së numrit të votuesve, përndryshe zgjedhjet në komunën përkatëse përsëriten.⁴ Për rrethin e dytë nuk kërkohet pjesëmarrje e caktuar e votuesve.

Zgjedhjet kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe me Kodin zgjedhor (KZ) të vitit 2006.⁵ Kushtetuta përcakton një diapazon të gjerë të të drejtave dhe të lirive themelore që i mbështesin zgjedhjet demokratike, duke e përfshirë edhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave.⁶ Që nga miratimi i saj, KZ-ja ka pësuar disa ndryshime pozitive dhe në përgjithësi ofron një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Një numër i madh i ndryshimeve ishin në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisionit të Venedikut), të Këshillit të Evropës, me ç'rast u bënë ndryshime kyçe me të cilat u përmirësua korniza për ndarjen e shtetit nga partia dhe rregullativa për financimin e fushatës. Megjithatë, mbeten disa kufizime, zbrazëtira dhe paqartësi të rëndësishme që kanë të bëjnë me një numër aspektesh ligjore, duke i përfshirë disa që janë përmendur në rekomandimet e

³ Numri i këshilltarëve për çdo komunë ndryshon prej 9 e deri në 33 këshilltarë; Qyteti i Shkupit ka 45 këshilltarë.

⁴ Ligji nuk parasheh se kur duhet të mbahen zgjedhjet e tilla të përsëritura.

⁵ Në ligjet e tjera të rëndësishme bëjnë pjesë Ligji për partitë politike, Ligji për financimin e partive politike, Kodi Penal, Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për kontestet administrative dhe ligjet që kanë të bëjnë me mediat.

⁶ Vendi nikoqir i ka ratifikuar të gjitha instrumentet kyçe ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, duke e përfshirë [Konventën e Kombeve të Bashkuara \(KB\) për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave](#), [Konventën e KB-ve për të drejtat e personave me pengesa](#) (KDPP) dhe [Konventën e KB-ve kundër korrupsionit](#) (KKK).

mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut.⁷ Në mes tjerash, këto kanë të bëjnë me të drejtat e votës, regjistrimin e kandidatëve, zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, dhe pavarësisht nga përmirësimet, me rregullativën për financimin e fushatës.⁸ Përveç kësaj, përkundër ndryshimeve, KZ-ja nuk i rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qartë të gjitha aspektet e rrethit të dytë, që nganjëherë çon në zbatim jokonsekuent të ligjit. Kjo ka të bëjë, për shembull, me përditësimin e listave të votuesve, aplikimin për votim në shtëpi, zëvendësimin e anëtarëve të Këshillave zgjedhorë (KZ), ndarjen e bilbordeve dhe hapësirave për posterë dhe akreditimin e vëzhguesve.⁹

Në vitin 2017 u futën dy ndryshime kyçe në KZ. Për shkak të formimit me vonesë të qeverisë, u ndryshua periudha e mbajtjes së zgjedhjeve lokale prej majit në tetor dhe u vazhdua mandati i kryetarëve aktualë të komunave. Poashtu, disa javë para zgjedhjeve dhe në kundërshtim me praktikën e mirë që rekomandon të ruhet korniza e qëndrueshme zgjedhore, Kuvendi u autorizua që ta ndryshojë përbërjen e Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ), që të jetë në përputhje me përbërjen e re të Kuvendit.¹⁰ Aq më tepër, ky ndryshim u realizua me procedurë të përshtypshme, pa konsultim të gjerë, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.¹¹ Miratimi i vonshëm e pengoi mundësinë për të kërkuar shqyrtim gjyqësor në kohë të këtij ndryshimi.

Kodi zgjedhor duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për t'i trajtuar mangësitë, zbrazëtitrat dhe paqartësitë e identifikuarra, duke i përfshirë edhe dispozitat për rrethin e dytë të zgjedhjeve, që të jetë në përputhje me përkushtimet, obligimet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë. Rishikimi dhe ndryshimet duhet të bëhen në procedurë publike, pas një procesi të gjerë inkluziv të konsultimeve dhe në një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të radhës.

Rregullat e miratuara nga KSHZ-ja e plotësojnë KZ-në. Megjithatë, koha dhe përmbajtja e ndryshimeve të kornizës rregullatore, nganjëherë e sfidoi integritetin e procesit zgjedhor. KSHZ-ja i miratoi dhe i ndryshoi disa rregulla gjatë periudhës zgjedhore, nganjëherë në momentin e fundit ose në bazë retroaktive.¹² Disa rregulla ishin në kundërshtim me ligjin, si për shembull rregullat për implementimin e kuotës gjinore dhe renditjen e garuesve në fletëvotim. Aq më tepër, në legjislacion nuk është paraparë shqyrtimi gjyqësor në kohë të rregullave të KSHZ-së.¹³

⁷ Shih Mendimin e përbashkët të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut për Kodin zgjedhor ([2011](#), [2013](#), [2016](#)).

⁸ Siç u theksua në raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it, poashtu ka nevojë për harmonizimin e ligjeve dhe të rregullativës për procedurat gjyqësore me dispozitat e KZ-së të cilat parashohin përjashtime për këto procedura, si për shembull rishikimi i propozim-vendimeve të KSHZ-së që ndikojnë në interesat e pakicave dhe zbulimi se si kanë votuar gjykatësit në rastet paszgjedhore.

⁹ Për shembull, dispozitat për votim në shtëpi nuk u zbatuan në mënyrë koneskuente në rrethin e dytë. Disa komisione zgjedhore kërkuan që votuesit që ishin pranuar për të votuar në shtëpi në rrethin e parë të aplikojnë përsëri, e disa komisione të tjera nuk e kërkuan këtë.

¹⁰ Ndryshimi u inicua nga Lëvizja BESA (BESA) e cila hyri në Kuvend për herë të parë në dhjetor të vitit 2016. Seksioni II.2.b i [Kodit të praktikës së mirë për çështjet zgjedhore](#) (Kodi i praktikës së mirë) i Komisionit të Venedikut i viti 2002 rekomandon që “elementet themelore të së drejtës zgjedhore, dhe, në veçanti, [...] përbërja e komisioneve zgjedhore [...] nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve”.

¹¹ Paragrafi 5.8 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) parasheh që legjislacioni “të miratohet në përfundim të një procedure publike”.

¹² Për shembull, rregulla për kuotën gjinore u ndryshua në masë të konsiderueshme pas afatit të fundit për paraqitjen e kandidatëve, rregulla për shortin për fletëvotimet u miratua në mbledhjen e njëjtë në të cilën u hodh shorti, rregulla me të cilën lejohej shfrytëzimi i letërnjoftimeve me afat të skaduar në rrethin e dytë, u anulua disa ditë para zgjedhjeve, vendimi me të cilin ndaloheshin ndryshime në Këshillat zgjedhorë pas rrethit të parë u miratua një javë pas ditës së zgjedhjeve.

¹³ Edhe pse Gjykata Kushtetuese ka kompetencë për ta shqyrtuar ligjshmërinë e rregullave (dhe shkëljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë), ajo nuk ka afat të fundit deri kur duhet të marrë vendim për këto raste.

KSHZ-ja duhet të ruajë një kornizë stabile rregullatore dhe duhet të përmbahet nga ndryshimi i rregullave gjatë periudhës zgjedhore, përveç shqyrtimit të rasteve emergjente. KSHZ-ja duhet të sigurojë se rregullat që zbatohen të mos jenë në kundërshtim me KZ-në apo të mos përputhen me të. Mund të konsiderohet futja e procesit të përshpejtuar për kontestet në lidhje me ligjshmërinë e legjislacionit dhe të rregullave që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet lokale u administruan nga administrata zgjedhore në tre nivele që përbëhet nga KSHZ-ja, 80 Komisione zgjedhore komunale (KZK) dhe Komisioni zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe 3,480 Këshilla zgjedhorë (KZ). Rrethi i dytë u administrua nga 35 KZK ku u mbajt rrethi i dytë dhe 1.517 (KZ) që janë nën to. KSHZ-ja është e mbështetur nga 34 zyra rajonale dhe sekretariati që përbëhet nga nëpunës shtetërorë. Përkundër sfidave organizative, administrata zgjedhore, në përgjithësi, siguroi që votuesit ta kenë mundësinë për t'i ushtruar të drejtat e tyre.

Në bazë të Marrëveshjes së Përzhinës të vitit 2015, KZ-ja u ndryshua që të ndryshohet përbërja e KSHZ-së nga modeli politik në atë të përzier dhe nga shtatë të ketë nëntë anëtarë. Tre anëtarë të KSHZ-së nuk kanë përkatësi partiake dhe zgjidhen nëpërmjet konkursit të hapur, ndërsa gjashtë anëtarët e tjerë e pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.¹⁴ Mandati pesëvjeçar i anëtarëve jopartiakë është i mbrojtur në mënyrë të arsyeshme, ndërsa të emëruarit partiakë, pas ndryshimeve të KZ-së në vitin 2017, duhej të ndërrohen që përbërja e KSHZ-së ta pasqyrojë përbërjen aktuale të Kuvendit. Në përputhje me këtë, më 22 shtator, anëtari i Lëvizjes BESA e zëvendësoi anëtarin e Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH).¹⁵ Ndryshimi i vonshëm në përbërjen e KSHZ-së ishte në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare. Bile, ndaj një anëtari të KSHZ-së ishte ngritur padi për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2013, gjë që e komprometoi perceptimin publik të KSHZ-së.¹⁶

Gjatë periudhës zgjedhore, KSHZ-ja jo gjithmonë i respektoi procedurat e saj të brendshme ose përshkrimin e detyrave të punës të anëtarëve të saj. Ndërhyrja e panevojshme e anëtarëve të KSHZ-së në punën e sekretariatit të saj rezultoi me tejkalim të afateve kohore, që kryesisht ndikoi në edukimin e votuesve dhe shtypjen e shablloneve me alfabet të Brejtit. Poashtu, gjatë diskutimeve të KSHZ-së për çështje të ndjeshme politike, siç ishin ankesat për mohimin e të drejtës për votim në shtëpi, anëtarët e saj kishin mungesë të qasjes kolegjiale dhe profesionale, ndërsa vendimet ishin të motivuara nga pozicionimi politik i anëtarëve të emëruar nga partitë, në vend që të bazohen në praktikën efikase dhe efektive.

Anëtarët e KSHZ-së duhet t'i përmbahen kërkesës ligjore për paanshmëri dhe procedurave të përcaktuara, si dhe t'i respektojnë përshkrimet e detyrave të punës që janë përcaktuar për anëtarët e KSHZ-së dhe sekretariatit.

Puna e KZK-ve kryesisht u vlerësua pozitivisht nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, dhe palët e interesuara, në përgjithësi, kishin besim në veprimet dhe vendimet e KZK-ve. KZK-të përbëhen nga pesë anëtarë, të cilët janë nëpunës shtetërorë, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme me mandat

¹⁴ VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja kanë nga dy anëtarë secila, si parti që kanë numër më të madh të deputetëve në Kuvend, e më pas vijnë BDI-ja dhe Lëvizja BESA me nga një anëtar.

¹⁵ Mandati i anëtarit të KSHZ-së duhej të përfundojë në vitin 2020; ankesa e tij për shkarkimin që u parashtrua në Gjykatën Administrative dhe në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit (KSHPK) u refuzua.

¹⁶ Padia e ngritur kishte të bëjë me një akuzë për keqpërdorim të pozitës nga ky anëtar gjatë shqyrtimit të një ankese pas-zgjedhore.

pesëvjeçar, nëpërmjet algoritmit të gjeneruar me kompjuter. KZ-të përbëhen nga dy anëtarë të emëruar politikisht dhe tre anëtarë jopartiakë. Tërësia e nëpunësve shtetërorë, nga e cila zgjidhen anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve, perceptohet si e politizuar nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it dhe procesi si i tillë nuk është transparent, që ndikon në besimin në administratën zgjedhore.¹⁷ Për shembull, shqetësime u ngritën nga bashkëbiseduesit e MVZ-së OSBE/ODIHR-it sa i përket anëtarëve të KZK-së në Likovë, të cilët perceptoheshin si mbështetës të kryetarit aktual.

Për të siguruar se anëtarët e KZK-ve dhe të KZ-ve kanë përvojë përkatëse profesionale dhe/ose për ta zvogëluar perceptimin se ka njëanshmëri në administrimin e zgjedhjeve, procesi i përzgjedhjes së tyre duhet të bëhet më transparent duke i publikuar listat e anëtarëve të mundshëm të KZK-ve dhe të KZ-ve, duke e hapur programin kompjuterik për verifikim nga ndonjë palë e tretë dhe duke e lehtësuar vëzhgimin e procesit.

KZ-ja parasheh kërkesa për balancë etnike dhe gjinore në përbërjen e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet.¹⁸ Kërkesa për balancë gjinore u përmbush në KSHZ, ku tre anëtare të saj ishin gra. Në 13 KZK nuk u respektua kuota gjinore.¹⁹ Pozitivisht, 28 për qind e KZK-ve kishin kryetare femra. Nuk kishte në dispozicion të dhëna në nivel shtetëror për përbërjen gjinore të KZ-ve. Emërimi i anëtarëve të KZ-ve filloi në gusht dhe disa ndryshime të vogla nëpër KZ vazhduan anëmbanë vendit deri pas përfundimit të rrethit të parë, kryesisht për shkaqe familjare ose shëndetësore.

Me ligj është paraparë që administrata zgjedhore punën e saj ta bëjë publike.²⁰ Megjithatë, në praktikë, KSHZ-së i mungonte transparenca e mirëfilltë. Edhe pse mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për mediat dhe vëzhguesit, jo gjithmonë njoftimet për mbajtjen e tyre jepeshin paraprakisht, dhe shpeshherë vendimet e rëndësishme merreshin në mbledhje të mbyllura.²¹ Jo të gjitha rregullat, vendimet dhe udhëzimet e KSHZ-së u bënë publike, e poashtu edhe Rregullorja për punë e KSHZ-së, e cila parasheh që procesverbalet duhet të publikohen brenda një jave pas mbajtjes së mbledhjes, shpeshherë nuk u respektua. KSHZ-ja dhe sekretariati i saj bënë disa përpjekje për ta përmirësuar transparencën ndërmjet dy rretheve zgjedhore, mirëpo vazhduan vonesat në postimin onlajn të informatave kyçe dhe të procesverbaleve, sikurse edhe praktika e marrjes së vendimeve në mbledhje të mbyllura.²²

Niveli i transparencës së KZK-ve ndryshonte. Përderisa shumica e tyre nuk i zbatuan masat për ta përmirësuar transparencën, disa të tjera ndërmorën iniciativa për ta rritur besimin në punën e tyre.²³ Për shembull, KZK-ja në Novo Sellë mirëmbante një faqe në Facebook, ndërsa KZK-ja në Jegunovcë i informonte në mënyrë proaktive palët e interesuara për mbledhjet e saj dhe më pas i shpërndante procesverbalet.

¹⁷ Shih poashtu [Raportin e përparimit për vitin 2016 të BE-së](#).

¹⁸ Asnjë gjini nuk duhet të jetë e përfaqësuar më pak se 30 për qind në cilindo qoftë komision zgjedhor. Në komunat ku ndonjë pakicë etnike përbën më pak se 20 për qind të popullatës së saj, duhet të zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat.

¹⁹ Shtatë KZK kishin më pak se 30 për qind anëtare gra, ndërsa 6 kishin më pak se 30 qind anëtarë burra. Nuk kishte të dhëna të tilla për përfaqësimin etnik.

²⁰ Shih nenin 19 të [Konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike](#) (KNDCP) për të drejtën për qasje në informata dhe paragrafët 18 dhe 19 të [Komentit nr. 34 për KNDCP të Komisionit të përgjithshëm për të drejtat e njeriut të KB-ve](#).

²¹ Rregulla e KSHZ-që me të cilën parashihet që ftesat të dërgohen dy ditë pune para se të mbahet mbledhja, shpeshherë u shpërfill.

²² Për shembull, më 23 tetor, KSHZ-ja vendosi kundër ndryshimeve në përbërjen e KZ-ve në mbledhje të mbyllur. Vendimi i njëjtë u votua përsëri në mbledhje të hapur më 24 tetor.

²³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it EOM hasi në mungesë të transparencës në 30 KZK.

Për ta rritur transparencën dhe besimin e publikut në punën e tyre, KSHZ-ja dhe KZK-të duhet t'i publikojnë me kohë rregullat, udhëzimet, vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të tyre, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me furnizimet.

Para rrethit të dytë, KSHZ-ja mbajti në kohë tre trajnime konsekuente për anëtarët e KZK-së, të cilët pastaj i trajnuan KZ-të për regjistrimin e kandidatëve, votimin e hershëm, dhe procedurat për votim, numërim dhe nxjerrje të rezultateve. Megjithatë, në ditën e zgjedhjeve, plotësimi i protokolleve me rezultate u paraqit si sfidë për shumë KZ, dhe për këtë arsye sekretariati i KSHZ-së i identifikoi KZ-të dhe KZK-të që kishin nevojë për trajnim plotësues para se të mbahet rrethi i dytë. Këto sesione trajnuese nuk ishin as të standardizuara e as nuk u mbajtën anembanë vendit, ndërsa ato që u vëzhguan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u vlerësuan si të pamjaftueshme. Pozitivisht, gjashtë KZK organizuan trajnime për KZ-të me iniciativë të veten. KSHZ-ja poashtu nuk e shfrytëzoi mundësinë që të ofrojë udhëzime plotësuese dhe instruksione qartësuese për KZK-të se si t'i korrigjojnë protokollet me rezultate që kanë gabime numerike, që ishte burim i konfuzionit gjatë nxjerrjes së rezultateve në rrethin e parë.

Për ta ngritur kapacitetin e KZK-ve dhe të KZ-ve dhe për të siguruar zhvillim konsekuent të zgjedhjeve, KSHZ-ja duhet të ofrojë trajnime në kohë dhe të njëtrajtshme, në veçanti për kompletimin e protokolleve me rezultate.

Pushtetet lokale janë përgjegjëse për financimin e zgjedhjeve, edhe pse disa prej tyre dështuan të ndajnë mjete buxhetore në mënyrë adekuate. Komunat, llogaritë e të cilave ishin të bllokuara me vendim gjyqësor për shkak të borxheve të papaguara, pranuan fonde nga buxheti shtetëror. Pas kërkesës së KSHZ-së, Ministria për Financa ndau 39 milionë denarë për 19 komuna të tilla, duke u bazuar në shpenzimet e zgjedhjeve paraprake.²⁴ Megjithatë, KSHZ-ja nuk i transferoi paratë në kohë, e as që parashikoi buxhet për rrethin e dytë të mundshëm.²⁵ Shtatë KZK e plotësuan mungesën e mjeteve financiare nga mjetet personale të anëtarëve të tyre. Së paku 14 KZK kishin mungesë të hapësirave adekuate dhe të pajisjeve.²⁶

Komunat duhet të sigurojnë planifikim financiar dhe operativ adekuat dhe në kohë, duke ua ofruar KZK-ve burimet e nevojshme shumë më parë se sa të mbahen zgjedhjet. Poashtu, autoritetet relevante duhet të sigurojnë që mjetet për cilëndo komunë, duke i përfshirë edhe ato me llogari të bllokuara, të transferohen në kohë.

KSHZ-ja nuk e përmbushi në mënyrë adekuate detyrën e saj për të ofruar edukim të votuesve.²⁷ Ajo planifikoi që shërbimet për edukim të votuesve t'i ofrojë ndonjë kompani e jashtme, mirëpo për shkak të problemeve të prokurimit, kjo nuk u realizua. Prandaj, KSHZ-ja vetëm e ndryshoi programin, e cili fillimisht ishte dizajnuar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2016. Për shpërndarjen e porosive u shfrytëzuan radiot, televizionet, mediat e shtypura dhe ato sociale, gjë që edhe pse ishte informuese dhe e dobishme, nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u vlerësua si mezi

²⁴ Përafërsisht 616,000 euro. 1 euro është e barabartë me 61 denarë.

²⁵ Për shembull, KSHZ-ja vendosi të transferojë 538,000 denarë për t'i mbuluar shpenzimet e transportit për rrethin e dytë madje më 25 tetor.

²⁶ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se KZK-të në Haraçinë, Demir Kapi, Konçe dhe Pllasnicë kishin pajisje joadekuate. KZK-të në Gazi Babë, Gjevgjeli, Radovish, Tearcë dhe Zhelinë kishin hapësira joadekuate për zyra. KZK-të në Bogovinë, Bërvenicë, Tearcë, Vrapçisht dhe Zhelinë kishin mungesë të fondeve.

²⁷ Paragrafi 11 i [Komentit nr. 34 për KNDCP të Komisionit të përgjithshëm për të drejtat e njeriut të KB-ve](#) parasheh se “fushatat për edukim të votuesve janë të nevojshme për të siguruar ushtrim efektiv të të drejtave nga neni 25 nga një komunitet i informuar”.

e dukshme. Video-klipet për edukimin e votuesve u shtuan javën e fundit para se të mbahen balotazhet, mirëpo përpjekjet e përgjithshme të KSHZ-së për të arritur deri te votuesit ishin minimale. Gjuha e shenjave nuk ishte shtuar në video-klipet e fushatës, e poashtu nuk u prodhuan materiale për personat me shikim të dëmtuar ose me pengesa mendore dhe intelektuale. Pozitivisht, KSHZ-ja në bashkëpunim me shoqërinë civile, i caktoi vendvotimet në të cilat kishte qasje për karrocet invalide dhe i vendosi këto informata onlajn. Poashtu, në disa komuna shoqëria civile bëri përpjekje për ta ndihmuar përfshirjen më të madhe të personave me pengesa dhe të komuniteteve të rrezikuara në procesin zgjedhor. Në Kumanovë, pati një iniciativë qytetare për t'u ndihmuar personave me pengesa për ta ushtruar të drejtën e tyre të votës, ndërsa në Prilep një OSHQ e ngriti vetëdijen për të drejtat e votimit në komunitetin rom.

Për ta përmirësuar ushtrimin efektiv të së drejtës për të votuar, KSHZ-ja duhet të zhvillojë dhe të implementojë program gjithëpërfshirës për edukim qytetar dhe të votuesve që do të realizohet në gjithë vendin, duke i përfshirë edhe votuesit me lloje të ndryshme të invaliditetit.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është marrë kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor. Ky kufizim është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe obligimet ndërkombëtare.²⁸ Për më tepër, vetëm personat me adresë të paraqitur në komunën përkatëse dhe me letërnjoftim të vlefshëm ose me pasaportë biometrike janë përfshirë në regjistrin e votuesve. Me këtë, në mënyrë efektive iu pamundësua e drejta e votës votuesve që i plotësonin kushtet, mirëpo të cilëve u kishte kaluar apo do t'u kalonte afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim para ditës së zgjedhjeve, dhe të cilët nuk kishin mundësi të nxirrin dokumente të reja të identifikimit para se të finalizohet lista. Kufizimet e tilla janë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese për të drejtën universale të votës dhe në kundërshtim me paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.²⁹

Siç është rekomanduar paraprakisht, KZ-ja duhet të korrigjohet që t'i përfshijë të gjithë votuesit që kanë të drejtë vote në listat e votuesve, pa marrë parasysh vlefshmërinë e dokumenteve të tyre të identifikimit. Në përputhje me obligimet ndërkombëtare, kufizimet e të drejtës së votës në bazë të vendimit gjyqësor duhet të hiqen, e poashtu duhet të ofrohen mekanizmat e nevojshëm mbështetës për ta ushtruar të drejtën e votës.

Poashtu, ligji nuk ka dispozita për votuesit në spitale, në institucionet për përkujdesje afatgjate dhe në shtëpitë e pleqve, dhe për këtë arsye këta votues nuk kishin mundësi të votojnë. KZ-ja përmban një dispozitë të përgjithshme për votimin në shtëpi, ndërsa rregulla e KSHZ-së saktëson se kush i plotëson kushtet për këtë.³⁰ Megjithatë, procedura e vështirë për aplikim, pa nevojë ua vështirësoi mundësinë për të votuar votuesve që i plotësonin kushtet, që është në kundërshtim me

²⁸ Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) kërkon nga Shtetet pjesëmarrëse “ta garantojnë në mënyrë universale dhe të barabartë të drejtën e votës për qytetarët e rritur”. Marrja e të drejtës së votës në bazë të paaftësisë mendore dhe intelektuale nuk është në përputhje me Nenin 12 dhe atë 29 të KDPP-së. Paragrafi 9.4 i [Komunikatës nr. 4/2011 të Komisionit të KDPP-së të vitit 2013](#) thotë se: “heqja e të drejtës së votës në bazë të paaftësisë së paramenduar ose faktike psikologjike ose intelektuale, duke e përfshirë edhe kufizimin në bazë të vendimit të individualizuar, paraqet diskriminim në bazë të paaftësisë”.

²⁹ Shih poashtu seksionet I.1.1 dhe I.1.2 të Kodit për praktika të mira. Neni 22 i Kushtetutës përcakton se “Çdo qytetar që ka mbushur 18 vjet e fiton të drejtën e votës. E drejta e votës është e barabartë, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë [...]”.

³⁰ Rregulla përfshin një listë gjithëpërfshirëse të gjendjeve shëndetësore që mund të krijojnë bazë për ta miratuar votimin në shtëpi dhe përcakton kërkesa të rrepta për dokumentacionin e nevojshëm.

standardet ndërkombëtare.³¹ Në disa raste, KSHZ-ja, duke e shkelur rregullën e saj, i hodhi poshtë vendimet e KZK-ve dhe miratoi votim në shtëpi për personat që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e shënuara në rregullën e saj.

Ligji duhet t'u ofrojë mundësi që ta ushtrojnë të drejtën e tyre të gjithë personave që kanë të drejtë vote duke i përfshirë votuesit në spitale, në institucionet për përkujdesje afatgjate dhe në shtëpitë e pleqve. Poashtu, duhet të konsiderohet mundësia për ta rishikuar rregullën për kushtet për votim në shtëpi për ta përmirësuar pjesëmarrjen.

Regjistrimi i votuesve është pasiv. KSHZ-ja e mirëmban regjistrin e votuesve në bazë të të dhënave të nxjerra nga regjistri qytetar dhe ai i popullatës. Ajo e përditëson regjistrin e votuesve katër herë në vit, në bazë të të dhënave që i ofrojnë institucionet e ndryshme shtetërore.³² Një ditë pasi të shpallen zgjedhjet, bëhet edhe një përditësim plotësues i regjistrit të votuesve. KSHZ-ja ka të drejtë të bëjë inspektime të rastësishme për verifikim të saktësisë. Për këto zgjedhje, KSHZ-ja nuk e pa të nevojshme që të bëjë verifikim gjithëpërfshirës të regjistrit të votuesve.³³

Këqyrja publike e listave të votuesve u bë prej 21 gushtit deri më 9 shtator. Gjatë kësaj periudhe, mbi 220.000 votues i kontrolluan të dhënat e tyre onlajn dhe personalisht, mirëpo vetëm 230 veta kërkuan të bëhen korrigjime.³⁴ Më 16 shtator, dy ditë pas afatit përfundimtar, partitë, mirëpo jo edhe kandidatët e pavarur, pranuan kopje të listave të votuesve. Partitë kërkuan vetëm disa ndryshime të vogla.³⁵ Si rezultat i kësaj, shumë bashkëbisedues shprehën besim të shtuar në integritetin e regjistrit të votuesve, ndërsa disa të tjerë vazhduan të shprehin shqetësim.

Për këto zgjedhje ishin regjistruar gjithsej 1.814.644 votues.³⁶ KSHZ-ja i miratoi listat përfundimtare të votuesve më 25 shtator, një ditë pas afatit të fundit zyrtar. Listat e shtypura të votuesve iu dërguan KZK-ve, të cilat pastaj ia dorëzuan ato KZ-ve. Nuk ka dispozita ligjore që parashohin përditësim të listave të votuesve ndërmjet dy rretheve zgjedhore, që në fakt ua pamundëson të drejtën e votës atyre që u ka kaluar afati i dokumenteve të identifikimit, me afat të kaluar, si dhe atyre që kanë mbushur 18 vjet ndërmjet dy rretheve zgjedhore, që është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare për të drejtën e votës.³⁷ Poashtu, 900 të burgosur nuk kishin mundësi të votimit për shkak se nuk mund të nxirrnin dokumente të reja të identifikimit.

Për ta përmirësuar saktësinë e listës së votuesve dhe për ta lehtësuar pjesëmarrjen e votuesve, duhet të konsiderohet përditësimi i listës së votuesve ndërmjet rretheve zgjedhore. Duhet

³¹ Paragrafi 11 i Komentit nr. 25 për KNDCP të Komisionit të përgjithshëm për të drejtat e njeriut të KB-ve përcakton se “Shtetet patjetër duhet të marrë masa efektive për të siguruar se të gjithë personat që kanë të drejtë vote kanë mundësi ta ushtrojnë këtë të drejtë”.

³² Ministria për Punë të Brendshme (MPB) informon për ndryshimet e vendbanimeve dhe regjistrin e dokumenteve për identifikim. Gjykatat themelore ofrojnë të dhëna të përditësuara për personat të cilëve u janë marrë të drejtat ligjore.

³³ Sidoqoftë, KSHZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se në bazë të shënimeve të pranuar nga MPB-ja, 7,007 njerëz që nuk kanë adresë të paraqitur dhe diku rreth 600 njerëz me adresë të panjohur nuk gjenden në listë.

³⁴ Gjatë këqyrjes publike, 203.191 votues i kontrolluan të dhënat e tyre onlajn dhe 21,594 në zyrat rajonale të KSHZ-së. Kishte 133 kërkesa për korrigjim të të dhënave, 65 njerëz janë shtuar në listë, 22 janë larguar për shkak të vdekjes dhe 10 kërkesa të natyrave të tjera.

³⁵ Partitë kërkuan shtimin ose fshirjen e gjithsej 49 votuesve. Kërkesat për shtim u pranuan, ndërsa ato për fshirje u refuzuan nga KSHZ-ja, për shkak se këto ndryshime janë në kompetencë të MPB-së, e jo të KSHZ-së.

³⁶ Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për të votuar në rrethin e dytë ishte 844,716.

³⁷ Lista e votuesve u mbyll për ndryshime nga votuesit prej 9 shtatorit e deri pas balotazheve të 29 tetorit.

konsideruar mundësia për ta zgjidhur periudhën e këqyrjes publike të listës së votuesve dhe afati i fundit për ndryshime të afrohet më afër ditës së zgjedhjeve.

Më 25 tetor, KSHZ-ja miratoi një vendim me të cilin votuesve që ishin në listë, mirëpo të cilëve u kishte kaluar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim prej datës 9 shtator e më tutje, nuk iu lejua të votojnë.³⁸ KSHZ-ja u bëri thirrje votuesve që të nxjerrin dokumente të reja para se të mbahet rrethi i dytë.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo votues me të drejtë vote që banon në komunën përkatëse mund të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që janë në burg ose atyre që janë në pritje të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj. Kandidatë mund të emërojnë partitë e regjistruara, koalicionet e partive ose grupet e votuesve, për kandidatët e pavarur. Këta të fundit emërimin e tyre duhet ta mbështesin me 100 deri në 1.000 nënshkrime, varësisht nga numri i votuesve në komunë, që është e barabartë me 0.2 deri në 4.8 për qind të votuesve me të drejtë vote që banojnë në komunën përkatëse.³⁹ Me këtë cenohet mundësia e barabartë e qytetarëve për të kandiduar në zgjedhje dhe kjo është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare, e cila rekomandon që nënshkrimet për mbështetje nuk duhet të tejkalojnë një për qind të numrit të votuesve.⁴⁰ Pozitivisht, siç u rekomandua paraprakisht nga OSBE/ODIHR-i, votuesit tani mund të nënshkruajnë për ta mbështetur më shumë se një kandidat. Megjithatë, akoma nënshkrimet duhet të mbledhen në prani të përfaqësuesit të KSHZ-së. Në komunitetet e vogla, kërkesat e këtilla mund të kenë efekt zbindës ose frikësues mbi disa votues.

Duhet konsideruar mundësia për standardizimin e numrit të nevojshëm të nënshkrimeve për kandidatët e pavarur deri në një për qind të votuesve të regjistruar në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Poashtu, siç është rekomanduar paraprakisht, duhet konsideruar mundësia për të ofruar metoda alternative për mbledhjen e nënshkrimeve me qëllim që të zvogëlohet mundësia për frikësim.

Pas një procesi inkluziv të regjistrimit, 19 parti politike dhe koalicione, si dhe 65 grupe votuesish, paraqitën gjithsej 6.630 kandidatë në 370 lista me kandidatë për këshillat komunalë dhe 258 kandidatë për kryetarë të komunave, duke përfshirë 19 kandidatë të pavarur për zgjedhjet për kryetarë të komunave. Regjistrimi i kandidatëve përfundoi më 19 shtator dhe listat u publikuan në ueb-faqen e KSHZ-së më 25 shtator, si dhe u vendosën para zyrave të KZK-ve për njoftim të votuesve.⁴¹ Pasi që KZK-të vendosin për regjistrimin, nuk kishte të dhëna në nivel shtetëror për numrin dhe arsyet e listave dhe kandidatëve të refuzuar.⁴² MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka njohuri për refuzimin e pesë listave me kandidatë, për të cilat u parashtruan ankesa deri te Gjykata

³⁸ Sipas KZ-së, votuesit duhet të tregojnë letërnjoftim ose pasaportë; nuk përmendet në mënyrë eksplicite vlefshmëria. KSHZ-ja poashtu e shfuqizoi një vendim që ka ekzistuar me vite, me të cilin votuesve u lejohej të votojnë në rrethin e dytë me dokumente të identifikimi që u ka kaluar afati.

³⁹ Në 18 komuna numri i nënshkrimeve të kërkuara tejkalon 2 për qind, ndërsa në 9 komuna kjo është mbi 3 për qind e të gjithë votuesve të regjistruar. Në Llozovë dhe në Vevçan, kjo përqindje ishte 4.8 për qind e votuesve të regjistruar.

⁴⁰ Shih nenin 3 të [KNDCP-së](#) dhe seksionin I.1.3.ii të Kodit të praktikës së mirë.

⁴¹ Afatet e fundit për regjistrim u zgjatën në komunat që u ndikuan nga një problem kompjuterik në Gjykatën Themelore Shkup 1, i cili e pamundësoi gjykatën disa ditë që kandidatëve t'ua lëshojë dokumentacionin e kërkuar për regjistrim.

⁴² KSHZ-ja nuk kërkon nga KZK-të që t'i raportojnë për të gjitha vendimet e tyre gjatë procesit të regjistrimit të kandidatëve.

Administrative, e cila i refuzoi të gjitha ankesat.⁴³ Megjithatë, listat dhe kandidatët e miratuar nuk mund të kundërshtohen në mënyrë ligjore. Një parti parashtroi ankesë ligjore kundër një koalicioni që garoi me emrin dhe logon e njëjtë sikurse edhe partia. Ankesa u refuzua për shkak se nuk është e ndaluar që një koalicion ose listë e dorëzuar nga një grup votuesish ta përdorë emrin dhe/logon e një partie të regjistruar.⁴⁴ Nuk ka dispozitë për tërheqjen e kandidatëve.

KZ-ja mund të ndryshohet që t'u ndalohet koalicioneve dhe listave të dorëzuara nga grupe të votuesve që ta përdorin emrin ose logon e njëjtë sikurse një parti e regjistruar dhe të rregullohet tërheqja e kandidatëve.

Në kundërshtim me KZ-në, KSHZ-ja organizoi dy shorte për renditjen e kandidatëve në fletëvotim, një për partitë dhe koalicionet, dhe tjetrën për grupet e votuesve. Me këtë u diskriminuan kandidatët e pavarur, për shkak se ata u vendosën në fund të fletëvotimeve.

Për ta përmirësuar barazinë gjinore, KZ-ja kërkon që në listat e kandidatëve të përfshihen jo më pak se 40 për qind e gjinisë më pak të përfaqësuar. Poashtu, së paku një kandidat nga çdo gjini duhet të vendoset në çdo vend të tretë në listë, e poashtu edhe në çdo vend të dhjetë.⁴⁵ Më 17 shtator, pas afatit të fundit për emërime, në përgjigje të kërkesave nga partitë politike, KSHZ-ja e ndryshoi rregullën duke përcaktuar në detaje se si duhet të zbatohet kuota për gjinitë. Kjo ishte në kundërshtim me KZ-në dhe e dëmtoi kuotën për gjinitë.⁴⁶ KZK-të regjistruan 9 lista me më pak se 40 për qind kandidate gra. Në 11 lista nuk kishte grua në çdo vend të tretë, ndërsa 6 lista nuk kishin një grua në çdo vend të dhjetë. KZK-të këtë ia përshkruan gabimeve gjatë mbikëqyrjes dhe atyre aritmetike. Megjithatë, posaçërisht një KZK që ka pranuar një listë me më pak kandidatë meshkuj se sa që duhet, ka kërkuar që ajo të korrigjohet. Katërmbëdhjetë për qind të të gjitha listave udhëhiqeshin nga gratë, ndërsa nga të gjithë kandidatët për kryetarë të komunave, vetëm gjashtë për qind ishin gra. Gjashtë kandidate gra për kryetarë të komunave kaluan në rrethin e dytë.

Partitë politike duhet t'i respektojnë kërkesat për kuotat e gjinive që janë përcaktuar në KZ, ndërsa KSHZ-ja dhe KZK-të duhet ta zbatojnë ligjin në mënyrë të rreptë. Duhet të ketë mundësi që miratimi i listave t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.

VIII. AMBIENTI I FUSHATËS

Fushata zyrtare për rrethin e parë filloi më 25 shtator dhe përfundoi në mesnatë të datës 13 tetor, ndërsa për rrethin e dytë zgjati prej 16 tetorit dhe përfundoi në mesnatë të datës 27 tetor.⁴⁷ Fillimi i fushatës para periudhës zyrtare, duke e përfshirë edhe mbajtjen e mbledhjeve me votuesit për t'i promovuar platformat e fushatës, është i ndaluar dhe dënohet me gjoba të larta. Përderisa periudhat zyrtare për zhvillim të fushatës mund të caktohen për të ofruar të drejta të veçanta, si

⁴³ Tre nga pesë listat u çregjistruan, për shkak se nuk kishin hapur llogari të veçantë bankare brenda afatit ligjor.

⁴⁴ Partia Aleanca për Shqiptarët u ankua për regjistrimin e Koalicioni Aleanca për Shqiptarët. Të dyja garuan në disa komuna. KSHZ-ja në instancën e parë dhe Gjykata Administrative pas ankesës e shqyrtuan rastin, përkundër faktit se nuk kanë juridiksion për këtë çështje.

⁴⁵ Në vitin 2015 kuota gjinore u rrit prej 30 në 40 për qind, dhe u shtua edhe një vend në çdo dhjetë vende. Këto ishin zgjedhjet e para lokal në cilat u zbatuar kuota e avancuar gjinore.

⁴⁶ Për shembull, rregulla parasheh se në komunat që kanë këshilla me 11 deri në 19 anëtarë, vendi më i poshtëm ku mund të vendoset gruaja është vendi i fundit, në vend që të jetë brenda dhjetë vendeve të para, siç kërkohet me KZ-në.

⁴⁷ Megjithëse KZ-ja nuk e rregullon në mënyrë të veçantë fillimin e fushatës në rrethin e dytë, supozohet se ajo fillon pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë.

për shembull qasje falas në media dhe hapësirë falas për posterat e fushatës, siç është theksuar edhe në raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, në përgjithësi, kufizimi i aktiviteteve të fushatës është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe garancitë kushtetuese për lirinë e të shprehurit dhe të tubimit.

Në KZ fushata është e rregulluar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në përgjithësi ofron kushte për terren të barabartë për garë, edhe pse kandidatëve të pavarur nuk u ofrohen kushte plotësisht të barabarta, si për shembull hapësirë e dedikuar për bilborde dhe mbulim mediatik. Ligji ka për qëllim t'i mbrojë votuesit nga presioni i panevojshëm, ta parandalojë blerjen e votave, ta mbështesë ndarjen e shtetit nga partia, si dhe ta ndalojë keqpërdorimin e burimeve administrative, duke i përfshirë ndalesat për shtetin dhe pushtetet lokale që të bëjnë pagesa që nuk janë paraparë në buxhet, të fillojnë projekte të reja të infrastrukturës publike, si dhe të ndërpresin marrëdhënie të punës ose të punësojnë njerëz të rinj në institucionet shtetërore ose publike.⁴⁸

KZ-ja duhet t'u garantojë kandidatëve të pavarur kushte të barabarta për zhvillim të fushatës me kandidatët e tjerë.

Para periudhës së fushatës zyrtare, më 5 shtator qeveria e miratoi Deklaratën për zgjedhjet e lira dhe të drejta, duke i bërë thirrje publikut dhe zyrtarëve shtetërorë që të përmbahen nga aktivitetet mashtruese dhe ta respektojnë të drejtën e votuesve që të zgjedhin në mënyrë të lirë.⁴⁹ Më 24 shtator në KSHZ dhe nëpër KZK-të, shumica e kandidatëve për kryetarë të komunave e nënshkruan Kodin e sjelljes duke premtuar se do ta respektojnë ligjin.⁵⁰ Ambienti para fushatës, në përgjithësi ishte i qetë, me disa incidente të izoluara, duke përfshirë disa dhunime të shtabeve zgjedhore.⁵¹ Kishte disa raste të garuesve që zhvilluan fushatë gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore. Për këtë çështje u parashtruan disa ankesa deri te organet për zbatimin e ligjit dhe administrata zgjedhore.⁵²

Fushata u zhvillua në një ambient ku liritë themelore për tubim dhe liria e shprehjes u respektuan në përgjithësi. Votuesve iu ofruan një varg mundësish për të zgjedhur, dhe në shumë komuna pati gara të rrepta. Fushatat filluan me tubime festive, ku liderët e partive i prezantuan kandidatët e tyre, i zbuluan sloganet e fushatës dhe i paraqitën platformat e politikave të tyre. Garuesit në zgjedhje u fokusuan në bazën e tyre partiake, realizuan vizita derë-më-derë dhe takime të përmasave të vogla. Nëpër qendrat urbane u paraqitën bilborde të mëdha, ku kryesisht ishin të paraqitur kandidatët për kryetarë të komunave.⁵³ Disa parti hapën shtabe të përkohshme zgjedhore ku u shpërndanë materialet e përgatitura nga nivelet qendrore të partive.

⁴⁸ Në maj të vitit 2017, Gjykata Kushtetuese i anuloi dy ndalesa që kishin të bëjnë me ndarjen e shtetit nga partia gjatë periudhës zgjedhore me arsyen se ato e kanë shkelur parimin kushtetues të sundimit të ligjit: ndalesën për menaxhimin e buxheteve dhe fondeve publike dhe atë për pagesën e subvencioneve jo të rregullta. Megjithatë, KSHPK-ja, që është organ përgjegjës për zbatimin e këtyre dispozitave, e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se konsideron se këto dispozita akoma janë në fuqi dhe se nuk janë të anuluar.

⁴⁹ Më 12 shtator, qeveria publikoi dy doracakë për institucionet shtetërore duke i potencuar ndalesat ligjore për sjelljen dhe aktivitetet e institucioneve publike dhe të punësuarve në to, dhe i potencoi burimet shtetërore që nuk duhet të shfrytëzohen për fushatë.

⁵⁰ Edhe pse KZ-ja parasheh që partitë politike ta nënshkruajnë Kodin e sjelljes për të gjitha zgjedhjet, kjo nuk ndodhi.

⁵¹ Më 24 shtator u dhunua shtabi i VMRO-DPMNE-së në Kisella Vodë dhe shtabi i LSDM-së në Aerodrom.

⁵² KSHZ-ja pranoi ankesë ku pretendohet se djali i një kandidati për kryetar të komunës ka bërë fushatë në një vendvotim në Strugë. MPB-ja pranoi tetë denoncime për gjoja zhvillim të fushatës në ditën e zgjedhjeve në rrethin e dytë.

⁵³ Edhe pse garuesve iu ofrua hapësirë falas për vendosjen e posterave të fushatës, materialet shpeshherë ishin të vendosura në vende të ndaluara. Poashtu, kishte edhe dëmtim të posterave.

Përdorimi i mediave sociale ishte një vegël e pashmangshme për zhvillimin e fushatës.⁵⁴ Shumë kandidatë hapën llogari zyrtare në Facebook, ku kryesisht postuan fotografi nga tubimet dhe takimet, në vend që të diskutojnë për çështje të politikave ose të bashkëveprimit me votuesit. Në përgjithësi, kandidatë e partive më të mëdha, veçanërisht ata të VMRO-DPMNE-së, i përdorën më shpesh mediat sociale në krahasim me partitë e tjera dhe kandidatët e pavarur. Garuesit poashtu blenë reklama në mediat elektronike, të shtypura dhe ato onlajn.

Strategjitë për fushatat lokale u përgatitën në nivel qendror, ndërsa u implementuan në nivel lokal. Para rrethit të dytë, disa liderë partiakë, gjatë mbajtjes së tubimeve në qendrat administrative bënë fushatë për çështjet shtetërore të stabilitetit dhe të integritetit, dhe i ndërlidhën ato me çështjet lokale të ujit, higjienës publike dhe infrastrukturës. VMRO-DPMNE-ja, dhe në masë më të vogël LSDM-ja, përdorën ton dhe mesazhe negative gjatë tubimeve.⁵⁵ Pavarësisht nga kjo, bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it në vazhdimësi vërejtën përmirësim në sjellje dhe në ambientin e fushatës.

Partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur zhvilluan fushata modeste ku i prezantuan vizionet e tyre për zhvillimin lokal. Një numër i tyre iu ankuan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për mungesën e terrenit të barabartë për garë dhe theksuan se kanë pasur vështirësi t'i financojnë fushatat, t'i paguajnë njerëzit e angazhuar në fushatë dhe të organizojnë ngjarje të përmasave më të mëdha gjatë fushatës në krahasim me partitë më të mëdha dhe të financuara më mirë.

Atmosfera në përgjithësi paqësore që u paraqit në rrethin e parë vazhdoi edhe gjatë rrethit të dytë. Para rrethit të dytë, ASH-ja formoi koalicion të ri me BESËN, ndërsa LSDM-ja e riafirmoi mbështetjen e saj për BDI-në. Strategjitë e fushatave u ridizajnuan në nivel qendror dhe kandidatëve iu dha autonomi më e madhe lokale. Në përgjithësi fushata për rrethin e dytë ishte e qetë dhe u bë dinamike vetëm disa ditë para zgjedhjeve. Kandidatët u fokusuan në komunikim të drejtpërdrejtë dhe në bashkëbisedim sy më sy me votuesit. Kishte vetëm disa tubime të mëdha dhe kandidatët e zvogëluan prezencën e tyre në rrjetet sociale. Disa garues u fokusuan në ato komunitete ku dalja në zgjedhje në rrethin e partë ishte shumë e ulët. Për shkak të garave të ngushta në zonat me shqiptarë etnikë, retorika e fushatës u bë më intensive dhe herë pas here agresive, në krahasim me komunat ku kishte balotazh ndërmjet kandidatëve të LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së. Pozitivisht, në Haraçinë, LSDM-ja e mbështeti një kandidate femër nga BDI-ja, e cila u zgjodh për kryetare të komunës. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se rrethi i dytë ishte më konkurrent, me ç'rast partitë garonin për të fituar mbështetje jashtë bazës së tyre tradicionale.

Jo gjithmonë u respektua ndarja e rreptë e administratës shtetërore nga aktivitetet e fushatës. Më 19 shtator, qeveria miratoi disa ligje me procedurë urgjente, me të cilat qytetarëve u mundësoi përfitime financiare dhe sociale.⁵⁶ Gjatë periudhës zgjedhore poashtu pati debat parlamentar për propozim-ligjin kontrovers për gjuhët, i cili përfshin status zyrtar për gjuhën shqipe. Para rrethit të dytë, kryeministri, disa herë në kapacitetin e tij zyrtar, iu drejtua elektoratit në tubimet e LSDM-

⁵⁴ Kandidati i ASH-së për kryetar komune në Strugë kishte numër më të madh të ndjekësve në faqen e tij në Facebook (56.000). Kandidatët më aktivë postonin prej 8 deri në 14 postime në ditë.

⁵⁵ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi 50 tubime në rrethin e parë dhe 5 tubime në rrethin e dytë. Partitë e mëdha politike mbajtën tubime në qendrat urbane, në vend të komunave rurale. Në përgjithësi, në tubime kishte mjaft njerëz, me ç'rast mesatarja ishte rreth 1.000 të pranishëm.

⁵⁶ Me ato ligje u rrit rroga minimale, u ofrua pagesë mujore për ish të punësuarit e ndërmarrjeve të privatizuara shtetërore, dhe u hoq taksa për radiodifuzion. Në bazë të Mendimit të KSHPK-së të datës 15 gusht, gjatë periudhës së zgjedhjeve me ligj janë të ndaluara të gjitha shqyrtimet e ligjeve.

së, dhe rregullisht e përdori llogarinë e tij zyrtare në Twitter për të dërguar mesazhe të fushatës.⁵⁷ Ai e promovoi inkluzivitetin, zhvillimin lokal dhe integrimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Disa parti shprehën shqetësime për premtimet nga ana e kryeministrit për mbështetje qeveritare për komunat që do të zgjedhin kryetarë nga radhët e LSDM-së ose të BDI-së.⁵⁸ Këto veprime e dëmtuan parimin e ndarjes së shtetit nga partia, i cili është paraparë në përkushtimet e OSBE-së.⁵⁹

Siç është rekomanduar paraprakisht, autoritetet duhet të tregojnë vullnet më të madh politik për të siguruar ndarje të mjaftueshme ndërmjet shtetit dhe partisë.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua nga bashkëbiseduesit për keqpërdorimin e burimeve administrative në disa komuna dhe ka njohuri se disa ankesa për këtë çështje janë parashtruar te organet relevante. Disa ishin të shqetësuar për fillimin e ndërtimit të rrugëve dhe projekteve të tjera infrastrukturore, që është në kundërshtim me KZ-në.⁶⁰ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u njoftua edhe për një numër rastesh që kanë të bëjnë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, transferimin ose punësimin e nëpunësve publike, që është në kundërshtim me KZ-në. Rastet e tjera përfshinin reklamimin e vendeve të punës për një kompani private nga një komunë dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare nga dy kryetarë aktualë të komunave.⁶¹ Poashtu, u ngritën padi ndaj dy kryetarëve të komunave për keqpërdorim të detyrës zyrtare, duke përfshirë një rast të shfrytëzimit të drejtpërdrejtë të burimeve administrative për zhvillimin e fushatës.⁶²

Gjatë gjithë fushatës, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti shumë pretendime për presion ndaj votuese dhe blerje të votave nga parti të shumta, me ç'rast disa nga këto pretendime ishin të besueshme.⁶³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua nga palë të ndryshme të interesuara për raste të tilla në së paku 10 komuna, me ç'rast presionet ndaj grupeve të rrezikuara dhe kërcënimet për

⁵⁷ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti ngjarje të tilla në Çair, Gazi Babë, Gostivar, Karbinci, Shuto Orizare, Staro Nagoriçan, Strugë dhe Vinicë. Poashtu, për shembull, më 27 tetor, në llogarinë e tij zyrtare në Twitter, në kapacitet të kryeministrit dhe të liderit të LSDM-së, ai premtoi se do ta ulë çmimin e ujit për 10 për qind për të gjitha amvisëritë në Shtip pas zgjedhjeve.

⁵⁸ Një numër i shqetësimeve u shprehën nga kandidatët e ASH-së dhe të BESË-s.

⁵⁹ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh “ndarje të qartë ndërmjet shtetit dhe partive politike, në veçanti se partitë politike nuk do të bashkohen me shtetin”. Në [Udhëzimet e OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2016 për parandalimin e dhe reagimin ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore](#) parashihet se “që të parandalohet keqpërdorimi i burimeve administrative për ta çekuilibruar terrenin e barabartë gjatë garave zgjedhore, korniza ligjore duhet të theksojë se gjatë fushatës nuk duhet të paraqiten njoftime të rëndësishme që lidhen me ose që kanë për qëllim të krijojnë perceptim të favorshëm ndaj ndonjë partie apo kandidati.”

⁶⁰ Për shembull, ankesat zyrtare pretendonin se në mënyrë të paligjshme janë inicuar projekte infrastrukturore në Kisella Vodë, Shtip, Bërvenicë, Kriva Pallankë dhe Strugë. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti ndërtim të rrugëve në disa komuna, duke përfshirë Tetovën. Në Gostivar, pushteti lokal nëpërmjet mediave kërkonte propozime për projekte për zhvillimin urban.

⁶¹ Në Demir Kapi, një njoftim qeveritar i vendosur në ndërtesën e komunës u bënte thirrje qytetarëve të aplikojnë për 200 vende pune në një kompani private. Një ankesë u parashtrua kundër kryetarit të komunës Qendra e Zhupës për gjoja shpërndarjen e materialeve ndërtimore, e poashtu MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti se kryetari i komunës së Pehçevës nuk ndau hapësirë falas për vendosjen e posterave të fushatës që është në kundërshtim me ligjin.

⁶² Ndaj kryetarit të komunës së Shtipit u ngrit padi për keqpërdorimin e detyrës (nuk ka të bëjë me zgjedhjet). Ndaj kryetarit të komunës së Novo Sellës u ngrit padi për keqpërdorimin e detyrës për gjoja shpërndarjen e materialeve të fushatës duke e përdorur veturën zyrtare.

⁶³ Në rrethin e parë në Studeniçan, një parti u ofroi votuesve punësim në administratë, në Koçanë, një kandidat u hetua për blerje të votave, në Demir Kapi një votues e informoi policinë se i janë ofruar para për votën e tij. Në Tetovë, një njoftim i komunës i vendosur në një ndërtesë për banim premtoi instalim të hidroforit (pompës për ujë) në vlerë prej 1.000 eurosh. Në rrethin e dytë 3 persona u paditën për shitje të votave dhe blerje të votave në Strugë dhe 1 në Shtip. Në Çeshinovë-Obleshevë dhe në Zërnovc 13 aktivistë partiakë u morën në pyetje nga policia për gjoja blerje të votave.

pasoja ndaj nëpunësve publikë ishin pretendimet më të shpeshta.⁶⁴ Megjithatë, u parashtruan vetëm disa ankesa zyrtare për këto çështje deri te organet përkatëse për zbatimin e ligjit. Çdo veprim që krijon atmosferë në të cilën votuesit ndiejnë se nuk kanë mundësi ta hedhin votën e tyre në mënyrë të lirë pa frikë nga hakmarrja është në kundërshtim me përkushtimet e OSBE-së.⁶⁵ Poashtu, një organizatë e shoqërisë qytetare (OSHQ) pranoi shumë ankesa për shfrytëzimin e të miturve në fushatat e pothuajse të gjitha partive, gjë që ngriti shqetësime të konsiderueshme për këtë çështje.⁶⁶

Të gjitha rastet dhe pretendimet për presion, frikësim, blerje të votave dhe keqpërdorim të burimeve administrative duhet të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe të ndiqen penalisht nga autoritetet, edhe atë në kohë. Poashtu duhet ketë arsim qytetar me qëllim që të synohen aktivitetet korruptive në fushatat zgjedhore me të dhëna nga organet përkatëse.

Pati disa incidente të izoluara, të motivuara politikisht, që përfshinin sulme ndaj shtabeve zgjedhore dhe dhunë ndaj një kandidati.⁶⁷ Para rrethit të parë, në Shuto Orizare, kandidati aktual për kryetar komune nga Unioni i Romëve të Maqedonisë (URM) u sulmua dhe u lëndua. Ndërmjet dy rretheve zgjedhore, vazhdoi armiqtësia ndërmjet mbështetësve të kandidatëve, që rezultoi me prezencë të madhe të policisë. Incidentet në Shuto Orizare i nxorën në shesh tensionet dhe nivelin e lartë të polarizimit brenda komunitetit rom.⁶⁸

Promovimi i pjesëmarrjes së grave në jetën publike nuk u trajtua në mënyrë të dukshme në fushatë.⁶⁹ Gjatë tubimeve, kandidatet gra shpeshherë ishin në skenën kryesore, mirëpo rrallë folën. Megjithatë, kandidatet gra që u takuan me MVZ-në e OSBE/ODIHR-it, nuk shprehën shqetësim sa i përket mungesës për mundësi të barabarta për të zhvilluar fushatë. Mesatarisht, 23 për qind e atyre që i ndoqën tubimet e vëzhguara ishin gra. Një pjesëmarrje më e vogël e grave u vërejt në tubimet që u mbajtën në zonat e shqiptarëve etnikë.⁷⁰ Në kuadër të ekipeve për menaxhim të fushatës, gratë nuk kishin pozita të dalluara udhëheqëse.

Rekomandohet që partitë politike dhe institucionet relevante të ndërmarrin iniciativa për ta inkurajuar pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor dhe në marrjen e vendimeve politike.

⁶⁴ Në rrethin e parë, në Çashkë, një zyrtar shtetëror u është kërcënuar familjeve se do t'i humbin përfitimet nga mbrojtja sociale. Një rast i ngjashëm ndodhi në Koçanë ndaj një familjeje rome, ndërsa në Dollnen ndaj personave që jetojnë në qendrat për përkujdesje sociale. Në Kavadar, një person i afërt me një parti u ka bërë presion dy të punësuarve që të sigurojnë 50 vota, dhe pasi kanë refuzuar janë përjashtuar nga puna. Në rrethin e dytë, në Zërnovc, një aktivist partiak u thirr për t'u marrë në pyetje në lidhje me gjoja frikësimin e votuesve, ndërsa në Veles një person ishte nën hetime për shkak të presionit ndaj të punësuarve që të votojnë në mënyrë të caktuar. Në Debresh, një zyrtar shtetëror i afërt me një parti gjoja i ka vizituar shtëpitë e votuesve duke kërkuar prej tyre që ta votojnë atë parti.

⁶⁵ Paragrafi 7.7. i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 kërkon nga Shtetet pjesëmarrëse "të sigurojnë se [...] as dhuna, veprimi administrativ, e as frikësimi nuk duhet t'i pengojë votuesit [...] ta hedhin votën e tyre pa u frikësuar nga hakmarrja".

⁶⁶ Poashtu, në komunën e Krushevës, në polici u denoncua një rast për shpërndarjen e materialit të fushatës së VMRO-DPMNE-së nga një nxënës në një shkollë fillore.

⁶⁷ Së paku 10 shtabe zgjedhore të BESËS, BDI-së, LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së u dhunuan. Kishte një tentim për ta spërkatur me sprej ish-kryeministrin nga radhët e VMRO-DPMNE-së, duke folur në një tubim në Shkup. Kandidati i BESËS në Saraj u kërcënuar pasi mori pjesë në një debat publik ku u diskutua për korrupsionin. Edhe pse nuk kishte të bëjë me zgjedhjet, një kandidat u vra në një incident në Kërçovë.

⁶⁸ URM është partia që ishte në pushtet në Shuto Orizare, dhe është aleate tradicionale e VMRO-DPMNE-së. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se ndryshimi i qeverisë e dobësoi pozitën e URM-së në nivel lokal dhe e ngriti besimin e kundërshtarëve të tyre, në veçanti të kandidatit të LSDM-së.

⁶⁹ [Vendimi i Këshillit të ministrave të OSBE-së nr.7/09 për Pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe atë publike](#) bën thirrje të "sigurohen masa të veçanta për arritjen e qëllimit për barazi gjinore në të gjitha organet legjislativë, gjyqësore dhe ekzekutive".

⁷⁰ Në zonat shqiptare, ndërmjet 5 dhe 10 për qind e të gjithë atyre që i ndoqën tubimet ishin gra.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Rregullat për financimin e fushatës kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, Komisionit të Venedikut, dhe të Grupit të shteteve kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO).⁷¹ Megjithatë, disa rekomandime të mëparshme dhe kufizime në kornizën ligjore mbeten të patrajuara, që e zvogëlon transparencën dhe llogaridhënien. Poashtu, janë ngritur shqetësime nga Komisioni Evropian për mungesën e vullnetit politik për të krijuar mekanizëm efektiv për mbikëqyrjen e financimit të fushatave, dhe për mandatet që përputhen në mes tyre të institucioneve të ndryshme dhe të organeve për zbatimin e ligjit.⁷²

Fushatat financohen nga anëtarësia partiake dhe donacionet private. Donacionet nga institucionet publike, donacionet nga jashtë, si dhe ato anonime, ndërmjet burimeve të tjera, janë të ndaluara. Donacionet janë të kufizuara në vlerën 3.000 euro për individë dhe 30.000 euro për subjektet juridike, duke i përfshirë edhe kontributet në natyrë. Limiti për shpenzim në fushatë është 1.8 euro për kokë të votuesve të regjistruar në komunë, për çdo rreth zgjedhor. Të gjitha transaksionet e fushatës duhet të realizohen nëpërmjet llogarisë së veçantë bankare për këtë qëllim.⁷³ Shpenzimet e fushatës kompensohen nga administrata lokale me çmim prej 0.24 eurosh për çdo votë që e fitojnë listat, të cilat fitojnë së paku 1.5 për qind të të gjitha votave të hedhura në një komunë.⁷⁴ Shkelja e pjesës më të madhe të rregullave për financimin e fushatës ka për pasojë anulimin e pjesëshëm ose të plotë të kompensimit dhe/ose shqiptimin e gjobave të rrepta, dhe në disa raste edhe dënim me burg.⁷⁵

Garuesit duhej të dorëzonin dy raporte të përkohshme në KSHZ, Entin shtetëror për revizion (ESHR) dhe KSHPK para rrethit të parë (më 5 dhe 14 tetor) dhe një në rrethin e dytë (më 28 tetor).⁷⁶ Një numër i madh i garuesve nuk i dorëzuan raportet e përkohshme deri në afatin e fundit apo nuk i dorëzuan fare, gjë që rezultoi me qasje të kufizuara në të dhënat për financimin e fushatës për votuesit para se ta hedhin votën e tyre. Shumë raporte u dërguan me postë dhe arritën pas ditës së zgjedhjeve, duke i përfshirë edhe raportet nga VMRO-DPMNE në të dyja rrethet.⁷⁷ Përkundër rekomandimit paraprak të OSBE/ODIHR-it, nuk janë paraparë dënime për mosdorëzimin në kohë të raporteve të përkohshme, gjë që e kufizon zbatimin e këtij obligimi.⁷⁸ Edhe pse raportet e përkohshme duhet të publikohen nga institucionet relevante dhe nga garuesit, nuk është paraparë afat i fundit për këtë. Vetëm KSHZ-ja e publikoi shumicën e raporteve menjëherë.⁷⁹

⁷¹ Shih [Raportin e dytë për harmonizim nga rrethi i tretë i vlerësimit të GRECO-s](#) të vitit 2014.

⁷² Shih [Raportin e vitit 2016 të Komisionit Evropian](#) për përparimin e vendit nikoqir në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE.

⁷³ Llogaria duhet të hapet në afat prej 48 orësh pas regjistrimit të listës me kandidatë. Në qoftë se nuk bëhet kjo, lista çregjistrohet.

⁷⁴ Shumat në KZ janë dhënë në euro.

⁷⁵ Edhe KZ-ja edhe Ligji për parandalimin e korrupsionit parashohin dënime financiare për shkeljet që kanë të bëjnë me financimin e fushatës. Disa gjopa janë në kundërshtim me njëra tjetrën.

⁷⁶ Sipas KSHZ-së dhe KSHPK-së, ato nuk i analizojnë raportet, por vetëm i publikojnë në ueb-faqet e tyre.

⁷⁷ Deri në afatin e fundit, KSHZ-ja ka pranuar vetëm 28 dhe 15 (nga gjithsej 84) raporte të para dhe të dyta të përkohshme, respektivisht, dhe vetëm 5 (nga gjithsej 10) raporte të përkohshme në rrethin e dytë. KSHZ-ja e vulosi raportin e fundit të përkohshëm të VMRO-DPMNE-së si të pranuar, edhe pse ishte pranuar me postë, disa ditë pas kalimit të afatit të fundit.

⁷⁸ Kompensimi i shpenzimeve të fushatës mund të suspendohet derisa të dorëzohet raporti i përkohshëm.

⁷⁹ ESHR-ja dhe KSHPK-ja nuk i publikuan raportet kur i pranuan, me atë që raportet e dyta dhe të treta u publikuan pas ditës së zgjedhjeve. Edhe pse nga partitë kërkohet që t'i publikojnë raportet e tyre, shumë prej tyre nuk e bënë këtë në kohë ose nuk e bënë fare.

Ministria e Financave e lëshoi një shabllon të ri për raportet, ku kërkohen informata gjithëpërfshirëse për të gjithë donatorët dhe donacionet, dhe në përputhje me rekomandimin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it, ndarje të detajuar të shpenzimeve, gjë që e përmirësoi transparencën. Megjithatë, raportet e përkohshme të disa partive, duke e përfshirë edhe LSDM-në, nuk i kishin ndarë në detaje shpenzimet për reklama, siç kërkohet në shabllon. Poashtu, sipas LSDM-së, në raportet e tyre janë paraqitur vetëm rreth gjysma e shpenzimeve për shkak se shumë fatura nuk i kishin pranuar, veçanërisht për reklamën në televizion.⁸⁰ Aq më tepër, disa parti shpenzuan më tepër se sa të hyrat që i kishin raportuar, gjoja duke shfrytëzuar kredi bankare për t'i financuar shpenzimet e tepërta, që është në kundërshtim me ligjin.⁸¹ Për disa raporte, veçanërisht ato të grupeve të votuesve, u shfrytëzua shablloni i vjetër që ka më pak detaje. Partitë më të mëdha politike i shpenzuan pjesën më të madhe të fondeve të fushatës së tyre për reklamim të paguar në mediat tradicionale dhe ato onlajn.⁸² Në trembëdhjetë raporte janë shënuar zero të hyra dhe shpenzime.

Me KZ-në duhet të kërkohet që raportet e përkohshme për financimin e fushatës të dorëzohen në mënyrë elektronike dhe duhet të vendosen dënime të përshtatshme për dorëzimin e vonshëm ose për mosdorëzimin e tyre. Shablloni duhet të përfshijë ndarje të shpenzimeve sipas komunave dhe duhet të kërkojë raportim të shpenzimeve të shkaktuara. Poashtu, ligji duhet të parashohë publikimin e raporteve të përkohshme dhe atij përfundimtar në ditën e dorëzimit të tyre.

ESHR-ja bën mbikëqyrje të financimit të fushatës, duke përfshirë edhe shqyrtimin e ankesave dhe përcjelljen e shkeljeve deri te organet relevante për zbatimin e ligjit.⁸³ Megjithatë, raportet e përkohshme financiare nuk i nënshtrohen analizës, gjë që e pengon zbulimin e hershëm të parregullsisve. ESHR-ja duhet të bëjë revizion të raporteve përfundimtare, të cilat dorëzohen në afat prej katër muajsh pas zgjedhjeve, që është një afat i zgjatur pa nevojë.⁸⁴ Në kundërshtim me praktikën e mirë, KZ-ja nuk e definon diapazonin e revizioneve, dhe ESHR-ja nuk ka kompetenca hetuese.⁸⁵ Sipas ESHR-së, ajo vetëm i verifikon të hyrat dhe shpenzimet, dhe nuk ka për qëllim zbulimin e shkeljeve. Aq më tepër, jo të gjitha raportet i nënshtrohen revizionit, për shkak të mandatit dhe burimeve të kufizuara të saj. Me këtë nuk përmbushen kërkesat për transparencë dhe llogaridhënie siç parashohin obligimet dhe standardet ndërkombëtare.⁸⁶ ESHR-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë dhe nuk ka përcjellë asnjë çështje deri te organet për zbatimin e ligjit.

⁸⁰ Shablloni kërkon të raportohen vetëm shpenzimet e faturuara. Shablloni aktual nuk kërkon që shpenzimet të ndahen sipas komunave, gjë që e pengon të caktohet se a janë ato në përputhje me kufizimet për shpenzime.

⁸¹ Për shembull, VMRO-DPMNE-ja, ASH-ja, BESA, PDSH-j, BDI-ja, "Levica" dhe disa kandidatët të pavarur raportuan më tepër shpenzime se sa të hyra.

⁸² Kjo ka të bëjë me LSDM-në, VMRO-DPMNE-në, BDI-në dhe BESËN.

⁸³ Në bazë të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, KSHPK-ja ka kompetencë për mbikëqyrjen e financimit të fushatës sa i përket shfrytëzimit të burimeve shtetërore dhe burimeve të paligjshme të donacioneve për fushatë. Siç parashihet me ligj, në vitin 2013 ESHR-ja, KSHPK-ja dhe KSHZ-ja nënshkruan memorandum për bashkëpunim për t'i këmbyer informatat për shkeljet gjatë financimit të fushatës.

⁸⁴ Paragrafi 200 i [Udhëzimeve të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2011 për Rregullat për partitë politike](#) (Udhëzime për rregullat për partitë politike) parasheh se "Raportet për financimin e fushatës duhet t'u dorëzohen organeve përkatëse brenda një periudhe jo më të gjatë se 30 ditë pas zgjedhjeve [...] Në përpjekje për ta mbështetur transparencën, është praktikë e mirë që raportet e tilla financiare të jenë në dispozicion në internet në kohë". Sipas ligjit, ESHR-ja ka 60 ditë për t'i bërë revizionet, edhe pse ajo nuk e interpreton këtë si afat të fundit për përfundimin e revizionit.

⁸⁵ Paragrafi 214 i Udhëzimeve për rregullat për partitë politike parasheh se "Organit rregullator duhet t'i jepen kompetenca për t'i monitoruar llogaritë dhe për të bërë revizion të raporteve financiare. Procesit [...] duhet të shënohet në legjislacionin relevant". Shih poashtu paragrafin 220.

⁸⁶ Neni 7(3) i [Konventës kundër korrupsionit](#) rekomandon që "çdo Shtet poashtu duhet të konsiderojë marrjen e masave të duhura legjislative dhe administrative [...] për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për postet e zgjedhura publike dhe, kur është e mundur, edhe për financimin e partive politike". Shih poashtu paragrafët 201-206 të Udhëzimeve për rregullat për partitë politike.

ESHR-së duhet t'i jepet kompetencë për t'i analizuar raportet, dhe t'i publikojë konstatimet e saj dhe shkeljet e mundshme t'ua përcjellë organeve përkatëse para ditës së zgjedhjeve. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve duhet të jetë në afat prej 30 ditësh pas zgjedhjeve. Ligji duhet ta përcaktojë diapazonin e revizioneve për të siguruar analizë gjithëpërfshirëse kundër çfarë do qoftë shkeljeje të mundshme dhe ESHR-së duhet t'i jepen kompetencat e nevojshme për hetim. Dënimet e parapara për të gjitha llojet e shkeljeve duhet të zbatohen.

X. MEDIAT

A. Ambienti mediatik

Ambienti mediatik që karakterizohet me një numër të madh të operatorëve që veprojnë në një treg relativisht të vogël, përfshin 170 media. Televizioni është burimi kryesor i informimit, qarkullimi i gazetave është i vogël, ndërsa depërtimi gjithnjë e më i madh i internetit ka mundësuar zhvillimin e dukshëm të ueb-faqeve me lajme. Përkrah tregut mediatik maqedonas ekziston edhe tregu mediatik në gjuhën shqipe.⁸⁷ Në përgjithësi, mediat janë të ndara në baza politike dhe akoma mbeten shqetësimet për nivelin e ulët të standardeve profesionale në një numër mediash gjë që e dëmton të drejtën e publikut për të pranuar raportim objektiv dhe të balancuar.⁸⁸

Në kuadër të transmetuesit publik, Radiotelevizionit të Maqedonisë (RTM), veprojnë TVM1, TVM2, kanali kuvendor, si dhe tre radio-stacione. Transmetuesi publik TVM2 (kanal në gjuhën shqipe) dhe stacioni televiziv privat *Alsat-M*, janë dy mediat kryesore në nivel shtetëror në gjuhën shqipe.⁸⁹ Transmetuesit privatë *TV Sitel*, *Kanal 5* dhe *Telma* janë kanalet më të shikuara në vend.

Më 19 shtator të vitit 2017, parlamenti e hoqi taksën për radiodifuzion me të cilën financohej transmetuesi publik, Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike (ASHAAM) dhe Radiodifuzioni i Maqedonisë (RDM). Nga 1 tetori i vitit 2017, këto institucione financohen vetëm nga buxheti shtetëror. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësim se kufizimet e këtilla për financim mund ta vështirësojnë punën e ASHAAM-it dhe ta dobësojnë edhe më shumë RTM-në si transmetues publik për shkak të ndërhyrjes së mundshme politike.⁹⁰

B. Korniza ligjore

Kushtetuta e garanton lirinë e të shprehurit dhe e ndalon censurimin. KZ-ja parasheh që të gjitha mediat, duke i përfshirë edhe ueb-faqet, t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme. Megjithatë, KZ-ja nuk parasheh në mënyrë eksplicite që të ketë mbulim të drejtë për kandidatët e pavarur. Reklamimi i paguar në mediat private është i rregulluar në mënyrë të rreptë, ashtu siç është i rregulluar edhe mbulimi i zgjedhjeve në lajmet e RTM-së.⁹¹ Poashtu, nga

⁸⁷ Ka 23 stacione televizive në gjuhën shqipe, 13 radio stacione dhe 3 gazeta.

⁸⁸ Me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2016 të KZ-së u trajtuan disa shqetësime, mirëpo reformat kyçe mediatike akoma nuk janë implementuar.

⁸⁹ *Alsat-M* poashtu i prodhon disa nga produktet e tij në gjuhën maqedonase, dhe programeve në gjuhën shqipe u shton titra në gjuhën maqedonase.

⁹⁰ RTM-ja, ASHAM-i dhe RDM-ja do të pranojnë gjithsej 0.5 për qind të buxhetit shtetëror për vitin 2018. 75 për qind e kësaj shume do t'i ndahet RTM-së. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it besojnë se nevojitet jo më pak se një për qind.

⁹¹ Sipas nenit 76-a të KZ-së, RTM-ja duhej t'ia kushtojë 30 për qind të edicioneve ditore të lajmeve aktiviteteve të fushatës së partive në pushtet, 30 për qind partive opozitare dhe 10 për qind të gjitha partive joparlamentare së bashku. Në mediat private radiodifuzive, secila nga partitë në pushtet dhe ato opozitare mund të blejnë deri në tetë minuta brenda një ore; ndërsa secila nga partitë e tjera parlamentare dhe joparlamentare është e kufizuar deri në një minutë brenda një ore.

RTM-ja kërkohet që garuesve politikë t'u ofrojë minutazh për emetim falas në periudhën me shikim më të madh. Para të dyja rretheve zgjedhore, ndarja e hapësirës kohore për emetim falas u përcaktua për datën që u kërkua nga ana e kandidatëve, që është në kundërshtim me dispozitat e KZ-së.⁹²

Respektimi i ligjeve nga ana e mediave monitorohet nga ASHAM-i, i cili shkeljet dhe ankesat eventuale ia përcjell gjykatës kompetente. ASHAM-i bëri monitorim sistematik të mediave dhe raportet i publikoi rregullisht në ueb-faqen e tij. ASHAM-i inicioi 14 procedura kundërvajtëse kundër nëntë mediave për shkelje që kanë të bëjnë me reklamimin e paguar politik, raportimin jo të balancuar, publikimin e anketave zgjedhore dhe shkeljen e heshtjes zgjedhore.⁹³ Gjykatat Themelore morën vendime për katër raste, me ç'rast në tre raste shqiptuan dënime më të ulëta se sa që janë paraparë në KZ dhe në një rast lëshuan paralajmërim zyrtar. Për dy vendime, ASHAM-i parashtroi ankesë me arsyetim se gjobat ishin të pamjaftueshme.⁹⁴ ASHAM-i e dëshmoi profesionalizmin e tij gjatë zgjedhjeve, duke e përmbushur mandatin e tij në tërësi. Megjithatë, efektiviteti i shqyrtimit gjyqësor të ankesave në lidhje me mediat u dëmtua për shkak të tejkalimit të afateve ligjore nga ana e gjykatave dhe shqyrtimit të gjobave më të ulëta se sa që janë paraparë me ligj. Për më tepër, bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me emërimin e Këshillit të ASHAM-it. Në shtator të vitit 2017, u propozuan ndryshime të reja në Ligjin për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike për ta ndryshuar procedurën për zgjedhjen e Këshillit të ASHAM-it dhe për të siguruar pavarësi nga ndërhyrjet politike.⁹⁵

Për ta ruajtur edhe më tutje rolin e ASHAM-it, anëtarët e tij duhet të emërohen në mënyrë që siguron pavarësi nga ndikimi politik.



C. Konstatimet e OSBE/ODIHR-it nga monitorimi i mediave

Rezultatet nga monitorimi i mediave nga ana MVZ-së së OSBE/ODIHR-it treguan se, siç është paraparë me KZ-në, RTM-ja u ofroi të gjithë garuesve minutazh falas në periudhën me shikim më të madh.⁹⁶ Megjithatë, vetëm 26 kandidatë e shfrytëzuan këtë mundësi në TVM1 gjatë rrethit të parë dhe 5 kandidatë gjatë rrethit të dytë. Kandidatët shqipfolës nuk kërkuan aspak minutazh falas në TVM2 në asnjërin rreth zgjedhor. Për fat të keq, RTM-së i mungoi raportimi i detajuar, duke e kufizuar vënien në dispozicion të informatave analitike për votuesit dhe ofroi mbulim të vogël të kandidateve dhe politikaneve gra.⁹⁷

⁹² Në bazë të politikës së brendshme të RTM-së, hapësirë prej tre dhe pesë minutash pa pagesë iu kushtua çdo kandidati për kryetar komune dhe çdo bartësi të listës me kandidatë për zgjedhjet për këshillat komunale, respektivisht.

⁹³ ASHAM-i filloi procedura kundërvajtëse kundër pesë transmetuesve nacionalë privatë *TV Alsat-M*, *TV Nova*, *TV 24 Vesti*, *TV 21*, *TV Alfa*. Tre transmetuesve rajonalë: *TV Star*, *TV Edo* dhe *TV KTV*. Një radio-stacioni, që në fakt është radioja publike RM1.

⁹⁴ Edhe pse KZ-ja parasheh gjoba prej 8.000 eurosh dhe 4.000 eurosh për këto shkelje, u shqiptuan vetëm dënime prej 4.500 eurosh dhe 2.250 eurosh, respektivisht.

⁹⁵ Ndryshimet kyçe të propozuara kanë për qëllim të sigurojnë pavarësi më të madhe nga partitë politike dhe kërkojnë që kandidati i propozuar të ketë letër mbështetjeje nga një prej disa organizatave të shoqërisë qytetare që i përfaqësojnë punëtorët mediatikë apo bashkësinë akademike. Anëtarët duhet të emërohen me shumicë prej dy të tretash në kuvend.

⁹⁶ Monitorimi i mediave nga ana e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it u realizua prej 21 shtatorit deri më 15 tetor, dhe prej 16 deri më 29 tetor, dhe përfshinte monitorim sasior dhe cilësor të mbulimit të çështjeve që lidhen me zgjedhjet të gjashtë kanaleve kryesore televizive: *TVM1*, *TVM2*, *Sitel*, *Kanal 5*, *Telma*, *Alsat-M* dhe të katër gazetave të përditshme: *Nova Makedonija*, *Sloboden Pecat*, *Veçer* dhe *Koha*.

⁹⁷ Në kuadër të emisioneve të lajmeve, TVM1 i kushtoi gjashtë për qind, ndërsa TVM2 pesë për qind aktoreve politike femra gjatë rrethit të parë dhe një për qind dhe gjashtë për qind, respektivisht në rrethin e dytë.

RTM-ja duhet ta përforcojë rolin e saj si transmetues publik duke e përmirësuar cilësinë e programeve. Ajo duhet ta promovojë pluralizmin, të ofrojë një diapazon më të gjerë të pikëpamjeve politike, ta profesionalizojë gazetarinë, të shpërndajë programe për edukimin e votuesve dhe ta rrisë pjesëmarrjen politike të grave duke u ofruar atyre mbulim më të madh në lajme.

Mbulimi i lajmeve në RTM, edhe pse në përputhje me KZ-në, i vendosi në pozitë të pafavorshme partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur. Në rrethin e parë, në TVM1, LSDM-ja kishte mbulim prej 37 për qind, VMRO-DPMNE-ja 32 për qind, BDI-ja 11 për qind dhe BESA 7 për qind. Të gjitha partive të tjera parlamentare iu kushtuan gjithsej 9 për qind të mbulimit mediatic, ndërsa partive joparlamentare 3 për qind dhe kandidatëve të pavarur 1 për qind. TVM2 u kushtoi më tepër kohë partive të shqiptarëve etnikë.

Në periudhën para rrethit të dytë, mediat e monitoruara kryesisht u fokusuan në rezultatet e rrethit të parë me raportim të kufizuar për fushatën e rrethit të dytë. Mbulimi në lajme kushtuar garuesve u zmadhua vetëm në javën e fundit të fushatës. Transmetuesi publik i kushtoi, në mes tjerëve, 25 për qind të mbulimit në lajme LSDM-së, 24 për qind VMRO-DPMNE-së, 20 për qind BDI-së, 15 për qind BESË-s dhe 9 për qind ASH-së.

Kërkesa ligjore që RTM-ja të ofrojë sasi të saktë të kohës në çdo emision të lajmeve kushtuar mbulimit të aktiviteteve të fushatës së partive duhet të zëvendësohet me një kërkesë më të përgjithshme për të mundësuar qasje dhe mbulim të barabartë në lajme për partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur, si dhe të ruhet balanca ndërmjet parimit për mundësi të barabartë ndërmjet garuesve, pluralizmit të pikëpamjeve dhe lirisë së gazetarëve.

Gjatë rrethit të parë, mediat private kryesisht ofruan mbulim të LSDM-së, edhe atë kryesisht për shkak të reklamave të paguara. LSDM-ja kishte mbulim prej 47 për qind, e ndjekur nga VMRO-DPMNE-ja me 29 për qind dhe BDI-ja me 17 për qind. LSDM-ja emetoi reklama me porosi negative gjatë gjithë fushatës në rrethin e parë.

Gjatë rrethit të dytë, kanalet private i kushtuan 40 për qind të mbulimit në lajme LSDM-së, 35 për qind VMRO-DPMNE-së, 9 për qind BDI-së, 9 për qind ASH-së, 4 për qind BESË-s dhe 2 për qind PDSH-së.⁹⁸ Një numër i madh i video-klipeve të paguara reklamuese, me ton negativ, u përdorën kryesisht nga VMRO-DPMNE-ja, dhe herë pas here nga LSDM-ja, sikurse në rrethin e parë.

Edhe mediat radiodifuzive publike edhe ato private organizuan debate ndërmjet kandidatëve për kryetarë të komunave në komunat e tyre përkatëse dhe në studion e RTM-së në Shkup. Debatet ishin të organizuara mirë, megjithatë, rezultatet nga monitorimi i mediave nga ana e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it treguan se një numër i madh i kandidatëve të ftuar të VMRO-DPMNE-së nuk morën pjesë në to. Tetë debate ndërmjet LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së u zhvilluan në kanalën publik TVM1 dhe në kanalën privat *Kanal 5*. Nuk pati debate ndërmjet kandidatëve etnikë shqiptarë dhe kandidatëve të pavarur para balotazheve.

Video-klipet për edukimin e votuesve të prodhuara nga KSHZ-ja dhe *iVote* u emetuan shpesh nga të gjitha mediat e monitoruara, veçanërisht në javën para ditës së zgjedhjeve.⁹⁹ Në rrethin e dytë, video-klipet për edukimin e votuesve ishin më të shkurtra dhe u emetuan më rrallë se sa në rrethin

⁹⁸ Në përgjithësi, mediat elektronike private që u monitoruan demonstuan një ton mjaft neutral ndaj kandidatëve gjatë mbulimit në lajme.

⁹⁹ *iVote* është kompani private që e fitoi kontratën e KSHZ-së për të ofruar edukim të votuesve.

e parë. Kanali në gjuhën shqipe TVM2 nuk emetoi asnjë video-klip për edukim të votuesve, sepse sipas transmetuesit, KSHZ-ja nuk u ka dhënë asnjë video-klip.

Në të dyja rrethet, gazetata e monitoruara në përgjithësi ofruan mbulim më të madh për dy partitë kryesore, LSDM-në dhe VMRO-DPMNE-në, dhe kishin ton neutral, përveç gazetës *Sllloboden Peçat*, e cila kishte mbulim tepër kritik, duke e përfshirë edhe tonin, ndaj kryetarit dhe kandidatëve të VMRO-DPMNE-së. Periudha e heshtjes zgjedhore u respektua në të dyja rrethet nga të gjitha mediat e monitoruara, me përjashtim të gazetës *Sllloboden Peçat*.

Më 29 tetor, një gazetar dhe një kameraman nga transmetuesi privat *TV 21-M* u kërcënuan dhe u penguan në kryerjen e detyrës së tyre. Më 2 nëntor, gjatë një rasti gjyqësor në Gjykatën Themelore Shkup 1, një kameraman i *TV 21-M* dhe një foto reporter nga një medie onlajn e lajmeve nga Kosova, u arrestuan nga policia dhe u mbajtën mbi gjashtë orë pa u dhënë mundësi që ta njoftojnë redaksinë ose familjet e tyre. Shoqata a gazetarëve të Maqedonisë dërgoi ankesë në MPB, duke e dënuar ashpër aksionin e policisë dhe kërkoi hetim të plotë të rastit.

XI. ANKESAT DHE APELIMET

Me KZ-në është paraparë një proces i centralizuar i ankesave zgjedhore, ku KSHZ-ja i shqyrton raste në shkallën e parë.¹⁰⁰ KZK-të nuk i trajtojnë ankesat, gjë që shkakton një barrë të panevojshme mbi organin më të lartë zgjedhor për të shqyrtuar, potencialisht, një numër të madh të ankesave brenda një afati të shkurtër kohor.¹⁰¹ Poashtu, sektori juridik i KSHZ-së, i formuar në vitin 2014, në përputhje me rekomandimin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it, nuk u shfrytëzua sa duhet dhe nuk funksionoi në mënyrë efektive, pjesërisht për shkak të politizimit të komisionit.¹⁰² Vendimet e KSHZ-së për ankesat dhe anulimet mund të apelojnë në Gjykatën Administrative, e cila është shkalla e fundit në pothuajse të gjitha rastet, ndërsa gjykatat themelore kanë juridiksion mbi rastet civile dhe penale që kanë të bëjnë me zgjedhjet.¹⁰³ Afatet e fundit për dorëzimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe të apeleve janë të shkurta pa nevojë, gjë që e pengon të drejtën për të kërkuar mjetet efektiv ligjor.¹⁰⁴

Duhet konsideruar decentralizimi i procesit të ankesave, e poashtu mund të përforcohen kapacitetet e KZK-ve për t'i shqyrtuar ankesat. Mund të përforcohet puna e KSHZ-së në lidhje me çështjet ligjore duke e shfrytëzuar në mënyrë efektive sektorin e tij ligjor. Afatet e fundit për

¹⁰⁰ Ankesat ndaj refuzimit të listave me kandidatë nga KZK-të parashtrihen drejtpërdrejtë në Gjykatën Administrative.

¹⁰¹ KZ-ja është e paqartë në lidhje me juridiksionin e KZK-ve për t'i shqyrtuar ankesat. Në të është shënuar shqyrtimi i ankesave si kompetencë e përgjithshme e KZK-ve, mirëpo nuk ka lloje të veçanta të ankesave që janë në kompetencë të tyre.

¹⁰² Për shembull, shefi i sektorit juridik nuk kishte dëshirë ose nuk kishte mundësi të japë mendim ligjor për KSHZ-në, pas kërkesës në lidhje me juridiksionin e saj për një çështje të caktuar të ankesës. Poashtu, sektori ligjor nuk e përgatiti mjaftueshëm KSHZ-në për t'i shqyrtuar ankesat paszgjedhore, që kontribuoi për joefikasitet të procesit.

¹⁰³ Vendimet e vetme të tjera të KSHZ-së që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor janë ato që ndikojnë në interesat e pakicave, të cilat mund të apelojnë deri në Gjykatën e Lartë Administrative.

¹⁰⁴ Shumica e afateve janë 24 ose 48 orë. Për shembull, ankesat për refuzimin e listave me kandidatë duhet të dorëzohen brenda 24 orëve dhe vendimi për to duhet të merret brenda 24 orëve. Nga ana tjetër, afati 7-ditor për të vendosur në lidhje me ankesat për zhvillimin e fushatës gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore është shumë i gjatë. Seksioni II.3.3 (95) i Kodit të Praktikës së Mirë thotë se "këto afate kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës së apelimit si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë paraqitjen e apelimit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm. Megjithatë, është e lejueshme që t'i jepet pak më shumë kohë [gjykatës më të lartë] për t'i marrë vendimet e saj."

dorëzimin dhe shqyrtimin e ankesave duhet të jenë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Sistemi gjyqësor nuk është i pavarur në aspekt strukturor dhe bashkëbisedues të ndryshëm kishin mungesë të besimit në aftësinë e gjykatave, organeve për zbatimin e ligjit dhe të administratës zgjedhore për t'i shqyrtuar në mënyrë të paanshme dhe efektive rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet.¹⁰⁵ Disa theksuan se nuk ia vlen të inicohen raste nëpërmjet këtyre kanaleve formale. Poashtu, pesë gjykatës të Gjykatës Administrative, ndaj të cilëve janë ngritur aktpadi për keqpërdorim të detyrës gjatë shqyrtimit të një ankesë kyçe në zgjedhjet lokale të vitit 2013, vazhduan t'i shqyrtojnë rastet në këto zgjedhje, që kontribuoi në perceptimin se ka njëanshmëri.¹⁰⁶

KZ-ja ofron një kornizë të kufizuar për mjetet efektive ligjore për kontestet zgjedhore. Edhe pse disa vendime të KSHZ-së dhe të KZK-ve i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, shumica e vendimeve nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, dhe për këtë arsye një numër i rëndësishëm i aspekteve të procesit zgjedhor janë në kompetencë përfundimtare të administratës zgjedhore. Kjo është në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe përkushtimet e OSBE-së.¹⁰⁷ Poashtu, palët e interesuara kanë të drejta të kufizuara për të kërkuar mjete ligjore për shkeljet që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.¹⁰⁸ Në kundërshtim me praktikën e mirë, votuesit mund t'i sfidojnë vetëm vendimet që ndikojnë saktësisht mbi të drejtën e tyre personale të votës. Vëzhguesit qytetarë nuk kanë të drejtë të parashtrajnë ankesa, vetëm garuesit mund t'i apelojnë rezultatet zgjedhore.¹⁰⁹

Të gjitha vendimet dhe (mos)veprimet e KZK-ve dhe KSHZ-së duhet t'u nënshtrohen mjeteve efektive ligjore në kohë dhe në mënyrë efektive. Votuesit dhe vëzhguesit qytetarë duhet të kenë të drejtë të parashtrajnë çfarëdo lloji të ankesës në lidhje me zgjedhjet, duke i përfshirë edhe ankesat në lidhje me rezultatet.

Para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, KSHZ-ja pranoi vetëm disa ankesa në kuadër të kompetencave të kufizuara të saj. Ajo e shqyrtoi dhe e anuloi vendimin e një KZK-je që nuk ishte në juridiksion të KZK-së, mirëpo vendimi asnjëherë nuk u publikua.¹¹⁰ KSHZ-ja i shqyrtoi nëntë ankesa në lidhje me mohimin e të drejtës për të votuar në shtëpi dhe i shfuqizoi ato, duke i anuluar vendimet e KZK-ve në përputhje me rregullativën e KSHZ-së. Jo të gjitha vendimet e KSHZ-së u

¹⁰⁵ Shih Raportin e grupit të ekspertëve të lartë ([Raporti i Pribes](#)) të shtatorit të vitit 2017, i cili e vlerëson gjyqësinë, zbatimin e ligjit dhe pavarësinë e institucioneve, dhe ofron rekomandime për t'i trajtuar mangësitë e tyre sistematike.

¹⁰⁶ Si masë parandaluese, Prokuroria speciale publike kërkoi nga gjykata themelore që t'ua ndalojë pesë gjykatësve të gjykojnë në rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Megjithatë, kërkesa u refuzua.

¹⁰⁷ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh se “çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave fundamentale dhe për ta siguruar integritetin ligjor”. Shih poashtu paragrafin 18.2 të [Dokumentit të Moskës së OSBE-së të vitit 1991](#), si dhe Rekomandimin [Rec\(2004\)20](#) të Këshillit të ministrave të Këshillit të Evropës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative. Kodi i praktikës së mirë thekson se “Organi i ankimit për çështje zgjedhore duhet të jetë ose një komision zgjedhor ose gjykata. Në çdo rast, duhet të jetë i mundur ankimi përfundimtar në gjykatë.”

¹⁰⁸ KZ-ja parasheh vetëm të drejtë për të parashtruar ankesë në KSHZ për zhvillimin e fushatës jashtë periudhës zyrtare dhe në gjykatë kundër garuesve të tjerë për ndërhyrje në aktivitetet e fushatës. Neni 2.3(a) i KNDQP-së i obligon shtetet që “të sigurojnë se çdo person, të drejtat ose liritë e të cilit, që janë të njohura këtu, janë shkelur, duhet të ketë mjet efektiv ligjor, pavarësisht nga ajo se shkelja është bërë nga personat që vepruar në kapacitet zyrtar”.

¹⁰⁹ Seksioni II.3.3. i Kodit të praktikës së mirë thekson se “tagri për apelim duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur... Çdo votues [...] duhet të ketë tagër për të bërë një apelim. Megjithatë, për apeline nga votues për rezultatet e zgjedhjeve mund të vendoset një kuorum i arsyeshëm.”

¹¹⁰ Një parti politike e sfidoi miratimin e listës me kandidatë të një koalicioni nga ana e një KZK-je, edhe pse vendimet për pranimin e listave me kandidatë nuk mund të rishikohen.

morën nga brenda afatit prej katër orësh për rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës për personale të votës. Para rrethit të dytë KSHZ-ja nuk pranoi asnjë ankesë. Në ditën e zgjedhjeve, KSHZ-ja vendosi në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me të drejtën e votës dhe kompetencën e mohuar në mënyrë të parregullt për dy ankesa që kishin të bëjnë me zhvillimin e fushatës në ditën e zgjedhjeve. Për këto dy ankesa, nuk lëshoi refuzime formale.

Me faktin që KSHPK-ja ka vetëm zyra qendrore, ajo ka kompetencë mbi ankesat për shkeljen e dispozitave të KZ-së që kanë për qëllim ndarjen e shtetit nga partia, keqpërdorimin e burimeve shtetërore, blerjen e votave dhe presionin ndaj votuesve.¹¹¹ Megjithatë, KSHPK-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se efektiviteti i saj është i kufizuar për shkak të kompetencave të pamjaftueshme dhe mungesës së bashkëpunimit me organet shtetërore të nivelit të lartë dhe organet për zbatimin e ligjit.¹¹² Edhe pse bashkëbisedues të ndryshëm të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën pretendime për praktika korruptive që kanë të bëjnë me zgjedhjet anëmbanë vendit, shumë pak ankesa për këto çështje u dorëzuan në KSHPK.¹¹³ Palët e interesuara theksuan se është e vështirë të vërtetohet frikësimi i votuesve dhe blerja e votave për shkak se dëshmitarët nguronin të paraqiteshin.¹¹⁴

KSHPK-ja pranoi 22 ankesa në lidhje me zgjedhjet. Ajo duhet të veprojë në lidhje me ankesat në afat prej pesë ditësh nga pranimi i tyre, që u interpretua si afat i fundit për të inicuar shqyrtim të rasteve, e jo për të marrë vendim përfundimtar. Shumica e rasteve kishin të bëjnë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës ose emërimin e nëpunësve publikë gjatë periudhës zgjedhore. Pesë raste u miratuan, ndërsa në një rast u dëshmuar se ndërprerja e marrëdhënies së punës ishte e motivuar politikisht.¹¹⁵ Në disa raste pati pretendime për fillim të paligjshëm të projekteve infrastrukturore dhe për furnizime qeveritare gjatë periudhës zgjedhore, si dhe për shfrytëzimin e burimeve shtetërore për prodhimin e materialit për fushatë. Shumica mbetën të pazgjidhura deri pas zgjedhjeve. Siç është e paraparë me ligj, të gjitha rastet u shqyrtuan në dëgjime publike dhe vendimet u postuan brenda 24 orëve.

Për shkak të interpretimit jokonsekuent të ndalesave që vlejën për qeverinë dhe organet publike gjatë zgjedhjeve, më 15 gusht KSHPK-ja e miratoi një mendim të përgjithshëm për atë se cilat lloje të veprimeve janë të ndaluara gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, KSHPK-ja pranoi mbi 1.000 kërkesa nga institucionet shtetërore dhe komunale për të dhënë mendim se a mund të ndërmerren veprime të caktuara që lidhen me buxhetin. Në fakt, përkundër mendimit të KSHPK-së se shkarkimi i Prokurorit publik do të paraqiste shkelje të KZ-së, ai megjithatë u shkarkua nga Kuvendi.¹¹⁶

¹¹¹ KSHPK-ja mund t'i anulojë vendimet e qeverisë dhe të organeve publike me të cilat shkelen këto dispozita, e poashtu mund t'ua përcjellë rastet organeve për zbatimin e ligjit, të cilat duhet ta informojnë atë për masat që i kanë ndërmarrë.

¹¹² Raporti i Pribes konstaton se "përveç dobësive në punën e KSHPK-së sistemi anti-korrupsion në përgjithësi karakterizohet me kapacitet të dobët rregullator, institucional në të gjitha nivelet, gjë që duhet të trajtohet".

¹¹³ KSHPK-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë për presion mbi votuesit dhe për blerje të votave, ndërsa MPB-ja hapi hetime për një numër të vogël rastesh për blerje të votave, presion mbi votuesit dhe keqpërdorim të burimeve shtetërore.

¹¹⁴ Ministria për Administratë dhe Shoqëri Informatike hapi një linjë telefonike për nëpunësit publikë për të denoncuar presione që kanë të bëjnë me zgjedhjet, mirëpo nuk është pranuar asnjë denoncim.

¹¹⁵ Njëmbëdhjetë nga këto raste u refuzuan, ndërsa një është akoma në shqyrtim pas periudhës zgjedhore. Disa vendime kishin mungesë të qartë të arsytimit dhe të mjeteve ligjore që mund të ndërmerren. Dy raste të refuzuara u apeluar pa sukses në gjykatë. Një rast i refuzuar është parashtruar nga anëtari i KSHZ-së mandati i të cilit u ndërpre nga Kuvendi.

¹¹⁶ Mendimi i miratua si përgjigje ndaj kërkesës së katër deputetëve të VMRO-DPMNE-së.

Duhet të përforcohen kompetencat e KSHPK-së për hetim dhe për zbatim të ligjit, si dhe bashkëpunimi me organet për zbatimin e ligjit për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Institucionet shtetërore duhet ta respektojnë në tërësi autoritetin e KSHPK-së. Hapja e zyrave rajonale të KSHPK-së ose prezenca e saj rajonale, veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore, mund të kontribuojë për ta penguar korrupsionin që lidhet me zgjedhjet. Poashtu, një afat konkret për të vendosur për ankesat do të sigurojë veprim efektiv dhe në kohë.

XII. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Për të kontribuar për transparencën e procesit zgjedhor, KZ-ja parasheh që vëzhguesit qytetarë dhe ata ndërkombëtarë të kenë qasje në të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe Kodi i sjelljes i KSHZ-së, që është i detyrueshëm, parasheh paanshmëri dhe mosndërhyrje në procesin zgjedhor. Në një proces të organizuar në kohë dhe inkluziv, KSHZ-ja akreditoi 6 organizata vëzhguese qytetare dhe 24 organizata vëzhguese ndërkombëtare. Vëzhguesit qytetarë i monitoruan përgatitjet për zgjedhje dhe zhvillimin e fushatës anembanë vendit, gjë që ofroi një vlerësim jopartiak të zgjedhjeve.

KSHZ-ja akreditoi rreth 3.000 vëzhgues qytetarë për të dyja rrethet zgjedhore; 2.800 nga MOST-i dhe 200 nga CIVIL-i. Përkundër mungesës së dispozitave ligjore për rrethin e dytë, KSHZ-ja lejoi që organizatat që ishin të akredituara të dorëzojnë lista të reja të vëzhguesve. Edhe garuesit në zgjedhje akredituan përfaqësues të tyre për t'i vëzhguar të dyja rrethet zgjedhore.

XIII. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Marrëdhëniet ndëretnike luajtën rol të kufizuar në zgjedhjet lokale të vitit 2017.¹¹⁷ Çështjet që ishin me rëndësi për marrëdhëniet ndërmjet bashkësive nuk u përdorën dukshëm në fushatë gjatë rrethit të parë. Gjatë fushatës për rrethin e dytë u vërejt retorikë konfrontuese dhe herë pas here agresive ndërmjet kandidatëve që i përkasin bashkësisë së njëjtë, në komunat ku partitë që i takonin koalicionit në pushtet në nivel shtetëror garuan në nivel lokal.

Shumica e kandidatëve dhe e listave e pasqyruan përbërjen etnike të komunës përkatëse. Në disa raste, kandidatët kërkuan të fitojnë vota përtej kufijve etnikë në balotazhet ndërmjet kandidatëve me përkatësi të njëjtë etnike. Në disa komuna, u formuan koalicione për t'i mbështetur kandidatët në rrethin e dytë që dallonin nga koalicioni në nivel qendror, gjë që bënte presion në marrëdhëniet ndërmjet partnerëve të koalicionit qeveritar. I tillë ishte rasti i aleancës ndërmjet ASH-së dhe BESËS, që ishte më i theksuar në Gostivar dhe Strugë.

Partitë që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike kanë paraqitur kandidatë për kryetarë të komunave vetëm në një numër të vogël komunash, atje ku janë të përqendruara këto grupe etnike, siç është rasti me turqit në Qendrën e Zhupës dhe Pllasnicë, dhe romët në Shuto Orizare. Në vendet e tjera, bashkësitë më të vogla paraqitën lista me kandidatë për këshillat komunalë qoftë me partitë që i përfaqësojnë këto bashkësi ose si anëtarë të koalicioneve më të mëdha. Në komunat ku votat e bashkësive më të vogla etnike janë vendimtare, kandidatët i kërkuan votat nga votuesit e këtyre grupeve etnike.¹¹⁸

¹¹⁷ Në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2002, 64.18 për qind u deklaruan si maqedonas etnikë, 25.17 për qind si shqiptarë etnikë, 3.85 për qind si turq etnikë, 2.66 për qind si romë etnikë, 1.78 për qind si serbë etnikë, 0.84 për qind si boshnjakë etnikë, 0.48 si vllahë etnikë dhe 1.04 për qind si të tjerë.

¹¹⁸ I tillë ishte rasti, për shembull, me turqit etnikë në Gostivar.

Partitë më të vogla etnike iu ankuan MVZ-së së OSBE/ODHIR-it se nuk kanë anëtarë të tyre në KSHZ dhe se nuk janë të përfaqësuar sa duhet nëpër KZK. Mediat shtetërore u kushtuan shumë pak minutazh dhe hapësirë kandidatëve që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla dhe temat që ishin me rëndësi për ta u mbuluan në mënyrë të kufizuar.

Mund të ndërmerren masa plotësuese për ta lehtësuar pjesëmarrjen e pakicave në çështjet publike dhe në zgjedhje. Në përputhje me kërkesën e paraparë në KZ për përfaqësim të drejtë të pakicave në organet për menaxhimin e zgjedhjeve, bashkësitë më të vogla duhet të përfaqësohen më mirë në administratën zgjedhore, edhe në nivel të KSHZ-së edhe në nivel të KZK-ve. Mediat duhet të ofrojnë hapësirë më të drejtë për partitë politike që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla. Fushatat për edukimin e votuesve dhe ngritjen e vetëdijes, duke e përfshirë edhe të drejtën për të votuar pa frikë nga hakmarrja, duhet t'i synojnë bashkësitë e pakicave dhe mundësisht të realizohen në gjuhët e tyre.

XIV. DITA E ZGJEDHJEVE (RRETHI I PARË)

Votimi i hershëm dhe dita e zgjedhjeve kaluan në mënyrë të rregullt në pjesën më të madhe të vendit. Megjithatë, u vërejtën disa parregullsi procedurale, në veçanti gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Nëntë raste të gjoja blerjes votave në pesë komuna u denoncuan në polici, tre prej të cilave u përcollën për ndjekje penale¹¹⁹. Dhjetë persona u arrestuan për fotografim të fletëvotimeve të tyre.¹²⁰ Transparenca u përmirësua me praninë e vëzhguesve partiakë dhe atyre qytetarë në 76 dhe 52 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, respektivisht. Në 55 për qind të KZ-ve të vëzhguara, kryetari ishte grua, ndërsa në përgjithësi anëtarët gra e përbënin shumicën.

A. HAPJA DHE VOTIMI

Votimi i hershëm u realizua më 14 tetor për gjithsej 6.916 votues (rreth 0.3 për qind e votuesve të regjistruar), duke i përfshirë votuesit në institucionet ndëshkuese, personat e zhvendosur në brendi të vendit dhe votuesit në shtëpi.¹²¹ Kjo u vlerësua negativisht në 14 nga 96 rastet e vëzhguara. Fshehtësia e votës u komprometua në 13 raste, ndërsa në 7 raste, KZ-të nuk e shfrytëzuan kabinën e votimit.

Përderisa votimi në burgje ishte i organizuar mirë dhe anëtarë të KZ-ve me njohuri të mira i ndoqën procedurat e parapara, shumë të burgosur nuk kishin mundësi të votojnë për shkak se ose nuk ishin përfshirë në listat zgjedhore ose u kishte kaluar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim. Mbi 900 votues në institucionet ndëshkuese anëmbanë vendit nuk kishin mundësi as ta kontrollojnë listën gjatë periudhës së këqyrjes publike e as nuk kishin mundësi të nxjerrin dokumente të reja të identifikimit me ndihmën e institucioneve relevante. Me këtë, këtyre votuesve iu mor e drejta e votës.¹²²

¹¹⁹ MPB-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se ka pranuar 89 denoncime në lidhje me shkeljet që janë bërë ditën e zgjedhjeve. Në një komunikatë të ardhme publike ajo raportoi se janë bërë 46 denoncime.

¹²⁰ MPB-ja inicoi procedura kundërvajtëse. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejt një rast të votuesit që e fotografoi fletëvotimin.

¹²¹ Sipas KSHZ-së, 5.025 votues në shtëpi, 1.882 votues në burgje dhe 9 persona të zhvendosur në brendi të vendit u regjistruan për votim të hershëm.

¹²² Komiteti për të drejtat e njeriut i KB-ve në [Vëzhgimet përfundimtare të Raportit të tretë periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë](#) (2015) thekson se “Shteti duhet të sigurojë se të gjithë qytetarët duhet të kenë qasje në të drejtat e votës, duke i përfshirë personat me invaliditet dhe personat e privuar nga liria. Shteti duhet të ndërmarrë masa për eliminimin e të gjitha pengesave administrative [...]”.

Për të garantuar se votuesit me të drejtë vote në institucionet ndëshkuese kanë mundësi ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës, autoritetet që janë përgjegjëse për përpilimin e listave të votuesve në këto institucione duhet të sigurojnë se të gjithë votuesit me të drejtë vote janë të përfshirë në listat e votuesve dhe se kanë mundësi për t'i rinovuar dokumentet e identifikimit që u ka kaluar afati i vlefshmërisë.

Më 15 tetor, hapja e vendvotimeve u vlerësua si e mirë ose shumë e mirë në 75 nga 82 vendvotime të vëzhguara. Shumica e vendvotimeve u hapën në kohë ose me një vonesë shumë të vogël dhe u vërejtën parregullsi shumë të vogla procedurale. Në 14 raste, protokollet nuk u plotësuan para hapjes së vendvotimit, dhe në 5 raste vëzhguesit partiakë ndërhyjnë në proces.

Votimi u vlerësua pozitivisht në 94 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Parregullsitë më të shpeshta përfshinin votim familjar/grupor dhe votim në emër të dikujt tjetër (8 dhe 2 për qind, respektivisht), kuti të votimit të mbyllura në mënyrë joadekuate (2 për qind) dhe tentime për të ndikuar në zgjedhjen e votuesit (1 për qind). Organizimi i hapësirës së vendvotimeve nuk mundësoi mbrojtje të mjaftueshme të fshehtësisë së votës në 2 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. KSHZ-ja pranoi kërkesa nga më shumë se 10 KZK për të marrë udhëzime se si të veprojnë në lidhje me parregullsitë; disa përfshinin anëtarë të KZ-ve që u kanë dhënë votuesve disa fletëvotime.¹²³ Në 3 për qind të vëzhgimeve vëzhguesit partiakë kanë ndërhyrë në punën e KZ-ve; disa gjoja i ndiqnin votuesit në vendvotime.¹²⁴ Të gjithë bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan se partitë politike dhe garuesit duhet të përmbahen nga ndërhyrja në punën e KZ-ve dhe duhet rreptësisht ta ndjekin detyrën e tyre.

Votuesit nuk mundën t'i gjejnë emrat e tyre në listat e votuesve në 9 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. KSHZ-ja pranoi mbi 45 ankesa në lidhje me mohimin e të drejtës së votës, kryesisht nga qytetarë që nuk ishin në listë për shkak të kalimit të afatit të vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim.¹²⁵ Shumica e tyre u refuzuan për shkak se lista nuk mund të ndryshohet pas përfundimit të saj.

B. NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE

Numërimi u vlerësua si efikas dhe transparent në 69 prej 78 vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, në 9 raste procedurat e parapara nuk u ndoqën, në 15 raste KZ-të nuk i anuluan në mënyrë adekuate fletëvotimet e pashfrytëzuara dhe nuk e caktuan numrin e votuesve që kanë votuar. Në 11 raste persona të paautorizuar i numëruan fletëvotimet. Në 12 raste, KZ-të u përballën me vështirësi gjatë plotësimit të protokolleve. Një e treta e KZ-ve të vëzhguara nuk i nxorën protokollet me rezultate për këqyrje publike.

Gjatë nxjerrjes së rezultateve, në 65 nga 71 KZK të vëzhguara, u ndoqën shumica e procedurave. Megjithatë, mangësitë në transparencë (3 raste), hapësira e pamjaftueshme (12 raste) dhe mosorganizimi (6 raste) e vonoi procesin në 6 KZK. Në 14 KZK, vëzhguesit nuk kishin qasje të mjaftueshme në procesin e futjes së të dhënave, gjë që e kufizoi transparencën.

Gjatë numërimit të votave në të dyja rrethet, vlefshmëria e fletëvotimeve u përcaktua në bazë të vendimit të KSHZ-së. Në kundërshtim me KZ-në dhe praktikën e mirë ndërkombëtare, ky vendim

¹²³ Në mbledhjen pas ditës së zgjedhjeve, KSHZ-ja vendosi t'i përcjellë rastet për procedim penal. KSHZ-ja nuk kishte mundësi t'i analizojë dhe t'i shqyrtojë disa nga kërkesat për shkak të kufizimeve kohore.

¹²⁴ Ndjekja e votuesve duke e shfrytëzuar listën e votuesve është vepër penale. KSHZ-ja u informua se policia ka konfiskuar një listë votuesish që është përdorur nga një person për t'i ndjekur votuesit në një vendvotim.

¹²⁵ KSHZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se edhe KZK të ndryshme kanë pranuar ankesa të tilla nga votuesit.

kërkonte nga KZ-të që t'i shpallin të pavlefshme disa fletëvotime në të cilat qëllimi i votuesit ka

qenë i qartë.¹²⁶ Kjo, së bashku me mungesën e dispozitave për fletëvotimet e dëmtuara pa qëllim dhe për fletëvotimet e zbrazëta, kontribuoi që të ketë një numër të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme.¹²⁷ Praktika e mirë rekomandon që të bëhet një përpjekje për ta “konstatuar qëllimin e votuesit”.¹²⁸ Numri i fletëvotimeve të pavlefshme u zvogëluar prej 4.2 për qind në rrethin e parë në 2.8 për qind në rrethin e dytë, me gjasë për shkak se votuesit kishin vetëm një fletëvotim për të votuar në rrethin e dytë.

KZK-të i nxorën rezultatet duke i futur të dhënat nga protokollat e KZ-ve në sistemin e unifikuar elektronik për menaxhimin e rezultateve. KSHZ-ja nuk i qartësoi procedurat për korrigjimin e gabimeve në protokolle, udhëzimeve të saj u mungonte qartësia dhe protokollat me rezultate të korrigjuara nuk u bënë publike.¹²⁹ Poashtu, KZK-të futën të dhëna me mospërputhje numerike në rezultate, që çoi në me mospajtime të konsiderueshme ndërmjet votave të hedhura dhe numrit të votuesve që kanë votuar.¹³⁰ Aq më tepër, nuk ka dispozita për futjen e protokolleve me rezultate në ueb-faqe dhe publikimin e tyre onlajn.

Për të siguruar transparencë dhe besim në procesin zgjedhor, të gjitha protokollat me rezultate, duke i përfshirë edhe ato që janë korrigjuar më vonë gjatë procesit, duhet të futen onlajn. Duhet të parashihen procedura të detajuara për korrigjimin e protokolleve me rezultate në KZK.

Rezultatet preliminare duhet të publikohen në afat prej 7 orësh pas përfundimit të votimit dhe në afat prej 10 orësh në Qytetin e Shkupit. Përderisa disa KZK e respektuan këtë afat të shkurtër, 49 KZK që kishin më tepër vendvotime për t'i përpunuar nuk kishin mundësi që t'i postojnë rezultatet në kohë. Për shkak të paketimit joadekuat të votave nga burgjet dhe problemeve logjistike në dorëzimin e votave nga burgjet në komunat përkatëse, rezultatet për komunat e Shkupit u publikuan në ueb-faqen e KSHZ-së më 17 nëntor. KSHZ-ja njoftoi në mënyrë preliminare se përqindja e daljes në votime ishte 60 për qind.

XV. DITA E ZGJEDHJEVE (RRETHI I DYTË)

Votimi i hershëm dhe dita e zgjedhjeve në përgjithësi ishin të menaxhuara mirë. Megjithatë, parregullsitë procedurale që u vërejtën gjatë numërimit të votave e zvogëluar vlerësimin pozitiv. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka njohuri për pesë raste të inicuar nga policia ndaj votuesve që i kanë fotografuar fletëvotimet e tyre.¹³¹ Dy raste të blerjes së votave në Shkup u përcollën për

¹²⁶ KZ-ja thekson se fletëvotimi është i vlefshëm nëse numri rendor i kandidatit është i rrethuar ose nëse është shënuar në mënyrë të “padyshimtë”. Megjithatë, vendimi i KSHZ-së dhe materialet për trajnim të KZ-ve theksojnë se çdo shenjë që është e ndryshme nga “rrethi i plotë” e bën fletëvotimin të pavlefshëm. Kodi i praktikës së mirë thotë: “Në rast të dyshimit, duhet bërë përpjekje për ta konstatuar qëllimin e votuesit”.

¹²⁷ Në rrethin e parë, në 7 komuna numri i votave të pavlefshme ishte aq i lartë sa që asnjëri dy kandidatët që garonin në zgjedhje nuk fitoi 50 për qind të të gjitha votave të hedhura, me çka u bë e detyrueshme mbajtja e rrethit të dytë.

¹²⁸ Seksioni I. 3.2.2.4 i Kodit të praktikës së mirë.

¹²⁹ Disa protokolle u korrigjuan pa i verifikuar materialet zgjedhore dhe protokollat e paraqitura në vendvotime nuk i përfshinin korrigjimet.

¹³⁰ Për shembull, rezultatet e gjithë vendit treguan se kishte mospërputhje prej 922 ndërmjet numrit të fletëvotimeve të hedhura dhe numrit të votuesve që kanë votuar në zgjedhjet për kryetarë të komunave dhe mospërputhje prej 310 në zgjedhjet për këshillat komunale, gjë që u mundësua nga përdorimi i kodit për futjen e të dhënave nga ana e KZK-ve, i cili e anashkaloi softuerin e dizajnuar për t'i zbuluar dhe për t'i penguar gabimet.

¹³¹ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it drejtpërdrejt vërejtë dy raste të votuesve që i fotografuan fletëvotimet e tyre.

ndjekje penale.¹³² U vërejt prezencë e fuqishme policore përreth vendvotimeve në disa komuna. Vëzhguesit partiakë dhe ata qytetarë ishin të pranishëm në 92 dhe 54 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, respektivisht. Në 53 për qind të vëzhgimeve, KZ-të ishin të udhëhequra nga gratë.

A. HAPJA DHE VOTIMI

Votimi i hershëm më 28 tetor u vlerësua pozitivisht në të gjitha 9 burgjet dhe në 40 nga 44 vëzhgimet e votimit në shtëpi. Vërejtjet negative të vëzhguesve kishin të bëjnë me komprometimin e fshehtësisë së votës dhe me mungesën e kutisë së votimit.

Në ditën e zgjedhjeve, hapja e vendvotimeve u vlerësua pozitivisht në 44 nga 45 vendvotime të vëzhguara. Integriteti i procesit nuk u ndikua nga një numër i vëzhguar i parregullsisve të imta zgjedhore. Në pesë raste, protokollet nuk ishin plotësuar, dhe në një komunë numri i votuesve të regjistruar që ishte shtypur në protokolle nuk ishte i saktë; nga KSHZ-ja u kërkuar ta korrigjojë gabimin.

Votimi u vlerësua pozitivisht në 97 për qind të vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë, në dy komuna u vërejtën tensione jashtë disa vendvotimeve për shkak të prezencës së aktivistëve partiakë.¹³³ Parregullsitë e vërejtura procedurale përfshinin votim familjar (6 për qind), komprometim të fshehtësisë së votës (2 për qind), dhe tejkalim të mandatit nga vëzhguesit partiakë (2 për qind). Pas kërkesave të pranuar, KSHZ-ja i këshilloi tre KZK si të vepronë në lidhje me parregullsitë e ndryshme.

Shabllon me alfabetin e Brajtit kishte në 62 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, që ishte një rritje e dukshme në krahasim me rrethin e parë të zgjedhjeve kur u vërejt se shabllon të tillë kishte vetëm në 8 për qind të vëzhgimeve. Megjithatë, sikurse edhe në rrethin e parë, mbi gjysma e vendvotimeve të vëzhguara nuk kishin qasje për karrocet invalidore. Pozitivisht, u siguruan kabina për votim me qasje për karrocet invalidore në mbi dy të tretën e vendvotimeve të vëzhguara.

Për ta inkurajuar pjesëmarrjen e barabartë të personave me invaliditet në zgjedhje, administrata zgjedhore duhet të ndër marrë masa plotësuese për ta përmirësuar qasjen në vendvotime.

B. NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE

Vendvotimet u mbyllën në kohë dhe shumica e KZ-ve i ndoqën procedurat për mbylljen e vendvotimeve. Megjithatë, numërimi u vlerësua negativisht në 8 nga 44 rastet e vëzhguara. Në 14 raste, KZ-të nuk e përcaktuan si duhet numrin e votuesve që kanë votuar, dhe në 9 raste nuk i numëruan fletëvotimet e pashfrytëzuara. Më shumë se gjysma e KB-ve të vëzhguara nuk i vendosën publikisht protokollet e rezultateve, gjë që e dëmtoi transparencën.

Nxjerrja e rezultateve ishte efikase dhe transparente në të gjitha 35 KZK-të e vëzhguara. Sistemi i centralizuar për menaxhimin e rezultateve funksionoi në mënyrë të rregullt në gjitha KZK-të, përveç njëres. Në 16 KZK, u korrigjuan një numër i protokolleve të rezultateve të KB-ve që kishin gabime numerike, që tregon se trajnimi për mënyrën se si duhet të plotësohen ato nuk ka qenë i mjaftueshëm. Ankesa zyrtare gabimisht u parashtruan në gjashtë KZK, në vend që ato të

¹³² Ministria për Punë të Brendshme pranoi gjithsej 28 denoncime për shkelje të ndryshme, duke përfshirë një rast të sulmit fizik në lidhje me zgjedhjet. U ngrit padi penale ndaj personi në ditën e zgjedhjeve për frikësim të votuesve.

¹³³ KSHZ-ja pranoi dy ankesa për presion mbi votuesit në vendvotime në Gazi Babë dhe Shuto Orizare. Avokati i popullit pranoi dy ankesa të ngjashme nga një vendvotim në Shtip.

dorëzohen në KSHZ, siç është paraparë me ligj.

KSHZ-ja filloi me publikimin onlajn të rezultateve paraprake sipas vendvotimeve një kohë të shkurtër pas mbylljes së votimit. Për dallim nga rrethi i parë, tani u respektua afati ligjor, dhe u vërejt një përmirësim në saktësinë e rezultateve të publikuara.¹³⁴ U njoftua se përqindja e daljes në votime ishte 51.92 për qind.

XVI. ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

A. ZHVILLIMET POLITIKE

KSHZ-ja i certifikoi zgjedhjet lokale më 14 nëntor. Në mesin e kryetarëve të zgjedhur të komunave, 57 e përfaqësojnë LSDM-në, 10 janë nga BDI-ja, 5 nga VMRO-DPMNE-ja, 3 nga ASH-ja, 1 nga BESA, 1 nga PSDH-ja, 1 nga Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni (PDTM) dhe 3 të pavarur. Nga kryetarët e zgjedhur të komunave, gjashtë janë gra, që është vetëm 7.4 për qind e të gjithë kryetarëve të komunave. Zgjedhjet për këshillat komunalë anembanë vendit, kryesisht u fituan nga LSDM-ja (41 për qind), VMRO-DPMNE-ja (32 për qind), pason BDI-ja (10 për qind), BESA (5 për qind), ASH-ja (5 për qind), PSDH-ja (1 për qind), partitë e tjera më të vogla dhe kandidatët e pavarur (4 dhe 3 për qind respektivisht). Gjithsej janë zgjedhur 455 gra, që paraqet 33.7 për qind të të gjithë këshilltarëve.

Atmosfera paszgjedhore në përgjithësi ishte e qetë dhe u bë dorëzimi paqësor i pushtetit. Këshilltarët komunalë dhe kryetarët e komunave që fituan në rrethin e parë, i morën certifikatat nga KZK-të përkatëse dhe filluan me detyrën e tyre zyrtare më 18 tetor.¹³⁵ Kryetarët e komunave të zgjedhur në rrethin e dytë e morën detyrën më 1 nëntor.¹³⁶ Në përgjithësi, zgjedhjet lokale të vitit 2017 u perceptuan si një hap i rëndësishëm në ndërtimin e kredibilitetit të qeverisë së re dhe kontribuan në përforcimin e besimit në procesin demokratik.

Lideri i LSDM-së deklaroi se zgjedhjet ishin të lira, demokratike dhe paqësore, ndërsa lideri i BDI-së theksoi se kryetarët e komunave nga radhët e partisë së tij do t'u shërbejnë të gjithë qytetarëve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Në të njëjtën kohë, VMRO-DPMNE-ja deklaroi se nuk do t'i pranojë rezultatet e zgjedhjeve pasi që ato kanë qenë zgjedhjet e organizuara më keq që nga pavarësia e vendit, të shoqëruara me kërcënime dhe dhunë të përmasave të mëdha ndaj votuesve.¹³⁷ VMRO-DPMNE-ja propozoi një plan shtatë-pikësh për rikthim të demokracisë.¹³⁸ Kryetari i ASH-së theksoi se do t'i pranojë të gjitha rezultatet përveç në Strugë, ku humbi.

¹³⁴ Në gjithë vendin kishte dallim prej gjashtë fletëvotimeve ndërmjet votave të hedhura dhe votuesve që votuan.

¹³⁵ Vetëm ato zgjedhje për të cilat nuk ishin parashtruar ankesa u vërtetuan më 18 tetor. Kryetarët e tjerë të komunave dhe këshilltarët e tjerë u vërtetuan më 24 tetor, pas përfundimit të procesit të apelimit.

¹³⁶ Vetëm ato zgjedhje për të cilat nuk ishin parashtruar ankesa u vërtetuan më 1 nëntor. Kryetarët e tjerë të komunave, përveç atij të komunës së Çairit, u vërtetuan më 6 nëntor, pas përfundimit të procesit të apelimit.

¹³⁷ Pas rrethit të dytë, VMRO-DPMNE poashtu njoftoi se partia nuk do të parashtrrojë asnjë ankesë tjetër për shkak se nuk e pranon legjitimitetin e zgjedhjeve.

¹³⁸ Ndërmjet propozimeve të tjera, plani përfshinte shpallje për të organizuar zgjedhje të parakohshme parlamentare, kryetar të ri të KSHZ-së dhe drejtori i ASHAM-it të emërohet nga opozita.

B. ANKESAT DHE APELIMET

KSHZ-ja është kompetente për shqyrtimin e ankesave në lidhje me parregullsitë në proceset e votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve, si dhe kundërshtimet e rezultateve. Vendimet e KSHZ-së mund të apelojnë në Gjykatën Administrative. Garuesit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesa në afat prej 48 orësh nga publikimi i rezultateve preliminare.¹³⁹ Megjithatë, KSHZ-ja shpalli një afat të fundit të unifikuar, duke mos e marrë parasysh kohën e saktë kur secila KZK i ka publikuar rezultatet e saj.¹⁴⁰ Me këtë u shkurtua në masë të konsiderueshme afati kohor për disa ankesa dhe kjo e dëmtoi të drejtën për të kërkuar mjet efektiv ligjor.¹⁴¹ Poashtu, afati i fundit i përcaktuar nga KSHZ-ja për të vendosur për ankesat ishte në kundërshtim me afatin e fundit ligjor dhe e shkurtoi atë.¹⁴² Për rrethin e parë, KSHZ-ja nuk arriti ta respektojë afatin e fundit prej 48-orësh për t'i shqyrtuar të gjitha ankesat.¹⁴³

Dispozitat e rrepta pa nevojë parashohin që KSHZ-ja t'i anulojë rezultatet e vendotimeve në rast të çfarëdo lloji të parregullsive procedurale, duke i përfshirë edhe ato të imtat, madje edhe atëherë kur parregullsitë nuk do të ndikonin në rezultat.¹⁴⁴ Kjo mund të çojë në heqjen e të drejtës së votës së votuesve, që është në kundërshtim me praktikën e mirë.¹⁴⁵ KZ-ja nuk definon mjaftueshëm se cilat lloje të provave do të konsiderohen si dëshmi për çështjet që do të vendosen gjatë shqyrtimit të kontesteve, e poashtu nuk është rregulluar edhe çështja e rinumërimit. Gjithashtu, për këto zgjedhje KSHZ-ja e ndryshoi procedurën e saj për ankesa, duke futur një dispozitë se ankesat nuk do të merren parasysh në qoftë se protokollet me rezultate nuk kanë vërejtje për parregullsinë e pretenduar nga përfaqësuesi i ankuesit.¹⁴⁶ Kjo dispozitë është në kundërshtim me KZ-në dhe ka një qasje teknike, që e dëmton mundësinë për të pasur mjet ligjor për ankesat legjitime.

Dispozitat për anulimin e rezultateve të vendotimeve duhet të ndryshohen që të mundësohet anulim vetëm në ato raste në të cilat shkeljet mund të ndikojnë në rezultatet e përgjithshme. Ligji duhet të përcaktojë rregulla të qarta dhe të arsyeshme për provat e ankesave, dhe ato duhet të zbatohen në mënyrë objektive dhe konsekuente.

KSHZ-ja pranoi 46 ankesa pas rrethit të parë, me ç'rast shumica dërrmuese u parashtruan nga VMRO-DPMNE-ja, si dhe 100 ankesa u parashtruan pas rrethit të dytë, pothuajse të gjitha nga

¹³⁹ Për ankesat në lidhje me parregullsitë në procesin e votimit, KSHZ-ja caktoi një afat të veçantë prej 48 orësh nga mbyllja e votimit, edhe pse KZ-ja nuk përcakton në mënyrë të qartë dy afate të fundit për ankesat pas zgjedhjeve.

¹⁴⁰ Në rrethin e parë, KSHZ-ja caktoi që afati i fundit të jetë në orën 02:00 më 18 tetor, duke u bazuar në supozimin e pasaktë se të gjitha KZK-të i kanë publikuar rezultatet paraprake deri në orën 02:00 më 16 tetor. Postimi i fundit i rezultateve nga KZK-të ishte në orën 22:00 më 17 tetor.

¹⁴¹ Në fakt, shumë ankesa kishin gabime dhe u mungonte qartësia, kurse indikatorët ishin përgatitur nxitimthi.

¹⁴² KSHZ-ja caktoi afat prej 48-orësh nga afati i fundit për dorëzimin e ankesave, për dallim nga afati i fundit ligjor prej 48-orësh nga pranimi i tyre. Poashtu, ankesat e shqyrtuan me renditje të rastësishme, e jo sipas kohës së pranimit.

¹⁴³ KSHZ-ja i shqyrtoi të gjitha ankesat pazgjedhore në një mbledhje që zgjati 23 orë, dhe nën presion të kohës, dukshëm e shpejtoi shqyrtimin e tyre në pjesën e dytë të mbledhjes.

¹⁴⁴ Shkaqet tjera përfshijnë rastet kur ka më tepër fletëvotime në kutinë e votimit, votimin në emër të dikujt tjetër dhe ndërprerjen e votimit për më shumë se tre orë.

¹⁴⁵ Seksioni II.3.3 (101) i Kodit për praktika të mira thotë se "organet apeluese [...] duhet të kenë kompetencë t'i anulojnë zgjedhjet në qoftë se parregullsitë kanë ndikuar në rezultat, p.sh. kanë ndikuar në shpërndarjen e mandateve."

¹⁴⁶ Në qoftë se nuk lejohet të shënohet vërejtja në protokoll, vërejtja mund të dorëzohet në KZK në afat prej pesë orësh prej kur ka ndodhur parregullsia.

BESA dhe ASH-ja.¹⁴⁷ Ankesat me të cilat kërkohet anulimi i rezultateve, pretendonin parregullsi të ndryshme të cilat bënin pjesë në arsyet që janë përcaktuar në ligj për anulimin e rezultateve të vendvotimeve.¹⁴⁸

KSHZ-ja i refuzoi të gjitha ankesat në të dyja rrethet zgjedhore. Anëtarët e saj vendosën për rastet sipas vijës partiake, që është në kundërshtim me kërkesën për paanshmëri, ndërsa mungesa e organizimit dhe e profesionalizmit e pengoi procesin.¹⁴⁹ U përdorën qasje formaliste dhe diskrete ku dukej qartë se qëllimi ishte të identifikohen arsyet për t'i refuzuar rastet, në vend që të ofrohet mjet efektiv ligjor. Edhe pse shumë raste në rrethin e parë u shqyrtuan në mënyrë thelbësore, megjithatë ndryshonte përpikëria, ndërsa në rrethin e dytë niveli i shqyrtimit u zvogëlu dukshëm.¹⁵⁰ Shumë raste u refuzuan duke përdorur rregulla arbitrare dhe të paarsyeshme për provat, ndërsa për disa vendime kishte mungesë të qartë të bazës së qëndrueshme ligjore.¹⁵¹ Disa raste nuk u shqyrtuan në mënyrë thelbësore për shkaqe teknike, duke mos e marrë parasysh mbrojtjen e të drejtave zgjedhore, që është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.¹⁵² Edhe pse të gjitha rastet u vendosën në mbledhje të hapur dhe ankesat dhe vendimet u publikuan menjëherë në ueb-faqen e KSHZ-së, që kontribuoi për transparencë, në përgjithësi mënyra se si u trajtuan ankesat e sfidoi sundimin e ligjit dhe rregullsinë e procesit, që është në kundërshtim me Përkushtimet e OSBE-së.¹⁵³

Njëzet e tetë vendime të KSHZ-së në lidhje me ankesat e rrethit të parë dhe pothuajse të gjitha vendimet në lidhje me ankesat e rrethit të dytë u apeluan në Gjykatën Administrative, pothuajse të gjitha brenda afatit të shkurtër prej 24-orësh. Rastet u vendosën nga panelet me pesë gjykatës, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, me ç'rast rastet u ndanë nëpërmjet sistemit kompjuterik.¹⁵⁴ Si

¹⁴⁷ Ankesat e rrethit të parë kishin të bëjnë me të gjitha vendvotimet në Qytetin e Shkupit dhe mbi 80 në nëntë komuna, ndërsa në rrethin e dytë kishin të bëjnë me të gjitha vendvotimet në Çair, dhe me gjithsej 25 vendvotime në Strugë, Tetovë dhe Çashkë.

¹⁴⁸ Shumë ankesa pretendonin se votuesve u janë dhënë më tepër fletëvotime ose fletëvotime të gabuara, se ka pasur numër të vogël të fletëvotimeve të tepërta ose të fletëvotimeve që kanë munguar në kuti, ose kopje të protokolleve që nuk janë plotësuar në tërësi, të panëshkruara ose numra që nuk përputhen. Në ankesat e tjera pretendohet se ka pasur presion mbi votuesit, votim grupor, votim të shumëfishtë, dhe votim në emër të dikujt tjetër, si dhe pretendime se shumë fletëvotime ku ka qenë i qartë vullneti i votuesit janë shpallur të pavlefshme. Kishte pretendime të ndryshme se anëtarët e KZ-ve u kanë bërë presion vëzhguesve partiakë që të mos shënojnë vërejtje në protokolle ose në KZK për parregullsitë e vëzhguara.

¹⁴⁹ Mbledhja e rrethit të parë u dominua nga katër anëtarë: dy anëtarët e emëruar nga VMRO-DPMNE-ja kërkonin që të miratohen ankesat e partisë së tyre, ndërsa dy anëtarët e emëruar nga LSDM-ja kërkuan që ato të refuzohen. Në rrethin e dytë, anëtarja e emëruar nga BESA kërkoi që të pranohen ankesat e partisë së saj, ndërsa anëtari i BDI-së kërkoi që ato të anulohen.

¹⁵⁰ Në disa raste, KSHZ-ja i thirri anëtarët e komisioneve të niveleve më të ulëta për t'i marrë në pyetje, i kontrolloi materialet zgjedhore dhe bëri rinumërim të votave. Rastet e tjera me pretendime të ngjashme u kontrolluan pak ose nuk u kontrolluan fare.

¹⁵¹ Shkaqet për refuzim përfshinin, për shembull, mungesën e vërejtjes për parregullsi në protokollin me rezultate, vendosjen e vërejtjes në vend të gabuar ose cilësinë e pamjaftueshme të vërejtjes, prezencën e vërejtjes në protokoll për shkeljen e caktuar, të shënuar nga anëtari i KZ-së ose KZK-së, faktin se KSHZ-ja e ka udhëzuar një KZK, me kërkesë të KZK-së, se si ta trajtojë parregullsinë konkrete ose ndonjë parregullsi të ngjashme, si dhe mungesën e natyrës serioze të shkeljes së arsyetuar.

¹⁵² Për shembull, një ankesë që dëshmonte se ishin ndërruar vendet e numrave të votave të dy partive në sistemin elektronik nuk u mor për shqyrtim dhe gabimi nuk u korrigjua, me arsyetimin se ankesa është dorëzuar në KZK e jo në KSHZ. Seksioni II.3.3 (96) i Kodit për praktika të mira thotë se “është e nevojshme të eliminohet formalizmi në mënyrë që të shmangen rastet kur apelimet refuzohen për gabime në hartimin e tyre, veçanërisht për rastet me ndjeshmëri politike.”

¹⁵³ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parasheh se “çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave fundamentale dhe për ta siguruar integritetin ligjor”.

¹⁵⁴ Gjykatësit ndaj të cilëve është ngritur padi për keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar gjatë gjykimit në lidhje me zgjedhjet lokale të vitit 2013, ishin në panele.

rregull e përgjithshme, në Gjykatën Administrative nuk mbahen mbledhje publike, që e kufizon transparencën dhe besimin e publikut në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore dhe që është në kundërshtim me kushtetutën dhe Përkushtimet e OSBE-së.¹⁵⁵ Megjithatë, gjykata mbajti mbledhje të hapura për të ofruar informata për rastet, siç parasheh KZ-ja. Vendimet e saj u morën brenda afatit kohor prej 48-orësh dhe u publikuan menjëherë.¹⁵⁶

Të gjitha ankesat e rrethit të parë u refuzuan në mënyrë unanime dhe të gjitha ankesat e rrethit të dytë, përveç njëres, u refuzuan, duke i lënë rastet e arsyeshme pa mjet efektiv ligjor. Tre vendime nga apelimet e rrethit të dytë nuk ishin unanime, me ç'rast votimi ishte katër me një, dhe të gjitha u miratuan nga paneli i njëjtë i gjykatësve për ankesat e parashtruara nga partia e njëjtë. Në vendime nuk u theksua se cilët gjykatës kanë votuar për, e cilët kundër, që është në kundërshtim me KZ-në. Një rast pjesërisht i kënaqshëm rezultoi me anulim të votimit në një vendvotim në Çair.¹⁵⁷ Për shkak se ky anulim ndikonte në rezultat, u mbajt votim i ripërsëritur në vendvotimin përkatës më 12 nëntor, siç është paraparë me ligj.¹⁵⁸

Anëtarët e KSHZ-së dhe gjykatësit e Gjykatës Administrative duhet të vendosin për ankesat me paanshmëri të plotë, duke e respektuar rreptësishtë ligjin dhe rregullsinë e procesit. Duhet shmangur qasja teknike ndaj ankesave. Për ta rritur transparencën, duhet të garantohen seanca publike gjyqësore për të gjitha rastet që kanë të bëjnë zgjedhjet.

XVII. REKOMANDIMET

Këto rekomandime, që gjenden në gjithë tekstin, janë ofruar për ta përmirësuar edhe më shumë zhvillimin e zgjedhjeve në vendin nikoqir dhe për t'i mbështetur përpjekjet për t'i sjellë ato në përputhje të plotë me përkushtimet e OSBE-së, obligimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, të cilat vendi nikoqir akoma nuk i ka trajtuar. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që t'u ndihmojë autoriteteve për ta përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për t'i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.¹⁵⁹

A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Kodi zgjedhor duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për t'i trajtuar mangësitë, zbrazëtirat dhe paqartësitë e identifikuara, duke i përfshirë edhe dispozitat për rrethin e dytë të zgjedhjeve, që të jetë në përputhje me përkushtimet, obligimet ndërkombëtare dhe praktikën e

¹⁵⁵ Kushtetuta i garanton seancat publike gjyqësore. Ligji për kontestet administrative parasheh mbajtjen e seancave të mbyllura në Gjykatën Administrative, përveç në rrethana të definuara. Paragrafi 12 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 thekson se "seancat mund të jenë të mbyllura ('in camera'), në kushte të parapara me ligj dhe në përputhje me detyrimet sipas ligjeve ndërkombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare". Shih poashtu Nenin 14 të KNDQP.

¹⁵⁶ Ueb-faqja e Gjykatës Administrative kishte probleme të kohëpaskohshme teknike, gjë që shkaktoi pak vonesë në postimin e vendimeve. Siç është e paraparë me ligj, KSHZ-ja menjëherë i publikoi vendimet e Gjykatës Administrative.

¹⁵⁷ Gjykata vendosi se KSHZ-ja në mënyrë të padrejtë nuk i ka analizuar të gjitha materialet zgjedhore pasi që ligji parasheh analizë të plotë në qoftë se është shënuar vërejtje në protokollin e KZ-së. Pas rinumërimit të cilin e urdhëroi gjykata u konstatua se kishte një fletëvotim tepër në kuti, gjë që paraqet bazë për anulim.

¹⁵⁸ Rezultatet e votimit të përsëritur nuk e ndryshuan rezultatin në komunën përkatëse dhe nuk u parashtruan ankesa.

¹⁵⁹ Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan "t'i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet".

mirë. Rishikimi dhe ndryshimet duhet të bëhen në procedurë publike, pas një procesi të gjerë inkluziv të konsultimeve dhe në një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të radhës.

2. KSHZ-ja duhet të ruajë një kornizë stabile rregullatore dhe duhet të përmbahet nga ndryshimi i rregullave gjatë periudhës zgjedhore, përveç shqyrtimit të rasteve emergjente. KSHZ-ja duhet të sigurojë se rregullat që zbatohen të mos jenë në kundërshtim me KZ-në apo të mos përputhen me të. Mund të konsiderohet futja e procesit të përshpejtuar për kontestet në lidhje me ligjshmërinë e legjislacionit dhe të rregullave që kanë të bëjnë me zgjedhjet.
3. Për ta rritur transparencën dhe besimin e publikut në punën e tyre, KSHZ-ja dhe KZK-të duhet t'i publikojnë me kohë rregullat, udhëzimet, vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të tyre, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me furnizimet.
4. Siç është rekomanduar paraprakisht, KZ-ja duhet të korrigjohet që t'i përfshijë të gjithë votuesit që kanë të drejtë vote në listat e votuesve, pa marrë parasysh vlefshmërinë e dokumenteve të tyre të identifikimit. Në përputhje me obligimet ndërkombëtare, kufizimet e të drejtës së votës në bazë të vendimit gjyqësor duhet të hiqen, e poashtu duhet të ofrohen mekanizmat e nevojshëm mbështetës për ta ushtruar të drejtën e votës.
5. Të gjitha rastet dhe pretendimet për presion, frikësim, blerje të votave dhe keqpërdorim të burimeve administrative duhet të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe të ndiqen penalisht nga autoritetet, edhe atë në kohë. Poashtu duhet ketë arsim qytetar me qëllim që të synohen aktivitetet korruptive në fushatat zgjedhore me të dhëna nga organet përkatëse.
6. Kërkesa ligjore që RTM-ja të ofrojë sasi të saktë të kohës në çdo emision të lajmeve kushtuar mbulimit të aktiviteteve të fushatës së partive duhet të zëvendësohet me një kërkesë më të përgjithshme për të mundësuar qasje dhe mbulim të barabartë në lajme për partitë më të vogla dhe kandidatët e pavarur, si dhe të ruhet balanca ndërmjet parimit për mundësi të barabartë ndërmjet garuesve, pluralizmit të pikëpamjeve dhe lirisë së gazetarëve.
7. Të gjitha vendimet dhe (mos)veprimet e KZK-ve dhe KSHZ-së duhet t'u nënshtrohen mjeteve efektive ligjore në kohë dhe në mënyrë efektive. Votuesit dhe vëzhguesit qytetarë duhet të kenë të drejtë të parashtrajnë çfarëdo lloji të ankesës në lidhje me zgjedhjet, duke i përfshirë edhe ankesat në lidhje me rezultatet.
8. Për të siguruar transparencë dhe besim në procesin zgjedhor, të gjitha protokollat me rezultate, duke i përfshirë edhe ato që janë korrigjuar më vonë gjatë procesit, duhet të futen onlajn. Duhet të parashihen procedura të detajuara për korrigjimin e protokolleve me rezultate në KZK.

B. REKOMANDIMET E TJERA

ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

9. Anëtarët e KSHZ-së duhet t'i përmbahen kërkesës ligjore për paanshmëri dhe procedurave të përcaktuara, si dhe t'i respektojnë përshkrimet e detyrave të punës që janë përcaktuar për anëtarët e KSHZ-së dhe sekretariatit.
10. Për të siguruar se anëtarët e KZK-ve dhe të KZ-ve kanë përvojë përkatëse profesionale dhe/ose për ta zvogëluar perceptimin se ka njëanshmëri në administrimin e zgjedhjeve, procesi i përzgjedhjes së tyre duhet të bëhet më transparent duke i publikuar listat e anëtarëve të

mundshëm të KZK-ve dhe të KZ-ve, duke e hapur programin kompjuterik për verifikim nga ndonjë palë e tretë dhe duke e lehtësuar vëzhgimin e procesit.

11. Për ta ngritur kapacitetin e KZK-ve dhe të KZ-ve dhe për të siguruar zhvillim konsekuent të zgjedhjeve, KSHZ-ja duhet të ofrojë trajnime në kohë dhe të njëtrajtshme, në veçanti për kompletimin e protokolleve me rezultate.
12. Komunat duhet të sigurojnë planifikim financiar dhe operativ adekuat dhe në kohë, duke ua ofruar KZK-ve burimet e nevojshme shumë më parë se sa të mbahen zgjedhjet. Poashtu, autoritetet relevante duhet të sigurojnë që mjetet për cilëndo komunë, duke i përfshirë edhe ato me llogari të bllokuara, të transferohen në kohë.
13. Për ta përmirësuar ushtrimin efektiv të së drejtës për të votuar, KSHZ-ja duhet të zhvillojë dhe të implementojë program gjithëpërfshirës për edukim qytetar dhe të votuesve që do të realizohet në gjithë vendin, duke i përfshirë edhe votuesit me lloje të ndryshme të invaliditetit.

REGJISTRIMI I VOTUESVE

14. Ligji duhet t'u ofrojë mundësi që ta ushtrojnë të drejtën e tyre të gjithë personave që kanë të drejtë vote duke i përfshirë votuesit në spitale, në institucionet për përkujdesje afatgjate dhe në shtëpitë e pleqve. Poashtu, duhet të konsiderohet mundësia për ta rishikuar rregullën për kushtet për votim në shtëpi për ta përmirësuar pjesëmarrjen.
15. Për ta përmirësuar saktësinë e listës së votuesve dhe për ta lehtësuar pjesëmarrjen e votuesve, duhet të konsiderohet përditësimi i listës së votuesve ndërmjet rretheve zgjedhore. Duhet konsideruar mundësia për ta zgatur periudhën e këqyrjes publike të listës së votuesve dhe afati i fundit për ndryshime të afrohet më afër ditës së zgjedhjeve.
16. Për të garantuar se votuesit me të drejtë vote në institucionet ndëshkuese kanë mundësi ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës, autoritetet që janë përgjegjëse për përpilimin e listave të votuesve në këto institucione duhet të sigurojnë se të gjithë votuesit me të drejtë vote janë të përfshirë në listat e votuesve dhe se kanë mundësi për t'i rinovuar dokumentet e identifikimit që u ka kaluar afati i vlefshmërisë.

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

17. Duhet konsideruar mundësia për standardizimin e numrit të nevojshëm të nënshkrimeve për kandidatët e pavarur deri në një për qind të votuesve të regjistruar në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Poashtu, siç është rekomanduar paraprakisht, duhet konsideruar mundësia për të ofruar metoda alternative për mbledhjen e nënshkrimeve me qëllim që të zvogëlohet mundësia për frikësim.
18. KZ-ja mund të ndryshohet që t'u ndalohet koalicioneve dhe listave të dorëzuara nga grupe të votuesve që ta përdorin emrin ose logon e njëjtë sikurse një parti e regjistruar dhe të rregullohet tërheqja e kandidatëve.
19. Partitë politike duhet t'i respektojnë kërkesat për kuotat e gjinive që janë përcaktuar në KZ, ndërsa KSHZ-ja dhe KZK-të duhet ta zbatojnë ligjin në mënyrë të rreptë. Duhet të ketë mundësi që miratimi i listave t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.

FUSHATA ZGJEDHORE

20. KZ-ja duhet t'u garantojë kandidatëve të pavarur kushte të barabarta për zhvillim të fushatës me kandidatët e tjerë.
21. Siç është rekomanduar paraprakisht, autoritetet duhet të tregojnë vullnet më të madh politik për të siguruar ndarje të mjaftueshme ndërmjet shtetit dhe partisë.
22. Rekomandohet që partitë politike dhe institucionet relevante të ndërmarrin iniciativa për ta inkurajuar pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor dhe në marrjen e vendimeve politike.

FINANCIMI I FUSHATËS

23. Me KZ-në duhet të kërkohet që raportet e përkohshme për financimin e fushatës të dorëzohen në mënyrë elektronike dhe duhet të vendosen dënime të përshtatshme për dorëzimin e vonshëm ose për mosdorëzimin e tyre. Shablloni duhet të përfshijë ndarje të shpenzimeve sipas komunave dhe duhet të kërkojë raportim të shpenzimeve të shkaktuara. Poashtu, ligji duhet të parashohë publikimin e raporteve të përkohshme dhe atij përfundimtar në ditën e dorëzimit të tyre.
24. ESHR-së duhet t'i jepet kompetencë për t'i analizuar raportet, dhe t'i publikojë konstatimet e saj dhe shkeljet e mundshme t'ua përcjellë organeve përkatëse para ditës së zgjedhjeve. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve duhet të jetë në afat prej 30 ditësh pas zgjedhjeve. Ligji duhet ta përcaktojë diapazonin e revizioneve për të siguruar analizë gjithëpërfshirëse kundër çfarë do qoftë shkeljeje të mundshme dhe ESHR-së duhet t'i jepen kompetencat e nevojshme për hetim. Dënimet e parapara për të gjitha llojet e shkeljeve duhet të zbatohen.

MEDIAT

25. Për ta ruajtur edhe më tutje rolin e ASHAM-it, anëtarët e tij duhet të emërohen në mënyrë që siguron pavarësi nga ndikimi politik.
26. RTM-ja duhet ta përforcojë rolin e saj si transmetues publik duke e përmirësuar cilësinë e programeve. Ajo duhet ta promovojë pluralizmin, të ofrojë një diapazon më të gjerë të pikëpamjeve politike, ta profesionalizojë gazetarinë, të shpërndajë programe për edukimin e votuesve dhe ta rrisë pjesëmarrjen politike të grave duke u ofruar atyre mbulim më të madh në lajme.

ANKESAT DHE APELIMET

27. Duhet konsideruar decentralizimi i procesit të ankesave, e poashtu mund të përforcohen kapacitetet e KZK-ve për t'i shqyrtuar ankesat. Mund të përforcohet puna e KSHZ-së në lidhje me çështjet ligjore duke e shfrytëzuar në mënyrë efektive sektorin e tij ligjor. Afatet e fundit për dorëzimin dhe shqyrtimin e ankesave duhet të jenë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.
28. Duhet të përforcohen kompetencat e KSHPK-së për hetim dhe për zbatim të ligjit, si dhe bashkëpunimi me organet për zbatimin e ligjit për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Institucionet shtetërore duhet ta respektojnë në tërësi autoritetin e KSHPK-së. Hapja e zyrave rajonale të KSHPK-së ose prezenca e saj rajonale, veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore,

mund të kontribuojë për ta penguar korrupsionin që lidhet me zgjedhjet. Poashtu, një afat konkret për të vendosur për ankesat do të sigurojë veprim efektiv dhe në kohë.

29. Dispozitat për anulimin e rezultateve të vendotimeve duhet të ndryshohen që të mundësohet anulim vetëm në ato raste në të cilat shkeljet mund të ndikojnë në rezultatet e përgjithshme. Ligji duhet të përcaktojë rregulla të qarta dhe të arsyeshme për provat e ankesave, dhe ato duhet të zbatohen në mënyrë objektive dhe konsekuente.
30. Anëtarët e KSHZ-së dhe gjykatësit e Gjykatës Administrative duhet të vendosin për ankesat me paanshmëri të plotë, duke e respektuar rreptësisht ligjin dhe rregullsinë e procesit. Duhet shmangur qasja teknike ndaj ankesave. Për ta rritur transparencën, duhet të garantohen seanca publike gjyqësore për të gjitha rastet që kanë të bëjnë zgjedhjet.

PAKICAT KOMBËTARE

31. Mund të ndërmerren masa plotësuese për ta lehtësuar pjesëmarrjen e pakicave në çështjet publike dhe në zgjedhje. Në përputhje me kërkesën e paraparë në KZ për përfaqësim të drejtë të pakicave në organet për menaxhimin e zgjedhjeve, bashkësitë më të vogla duhet të përfaqësohen më mirë në administratën zgjedhore, edhe në nivel të KSHZ-së edhe në nivel të KZK-ve. Mediat duhet të ofrojnë hapësirë më të drejtë për partitë politike që i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla. Fushatat për edukimin e votuesve dhe ngritjen e vetëdijes, duke e përfshirë edhe të drejtën për të votuar pa frikë nga hakmarrja, duhet t'i synojnë bashkësitë e pakicave dhe mundësisht të realizohen në gjuhët e tyre.

VOTIMI, NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE

32. Për ta inkurajuar pjesëmarrjen e barabartë të personave me invaliditet në zgjedhje, administrata zgjedhore duhet të ndërmarrë masa plotësuese për ta përmirësuar qasjen në vendvotime.

ANEKSI I: REZULTATET ZGJEDHORE¹⁶⁰

Zgjedhjet për këshillat komunale, 15 tetor

Partia	Votat e hedhura (preliminare)		Këshilltarë komunalë (gjithsej)	Këshilltare komunale femra	
	Për qind	Numri i votave		Numri i këshilltarëve	Për qind
LSDM	40.78	418,477	551	214	38.84
VMRO	32.75	336,075	432	150	34.72
BDI	8.73	89,586	128	40	31.25
ASH	4.79	49,154	63	15	23.81
BESA	4.53	46,486	65	15	23.08
PDSH	1.64	16,829	18	5	27.78
PDTM	1	10,262	17	3	17.65
LUKT	1	10,262	3	0	0
Koalicioni ASH	0.33	3,386	2	0	0
“GROM”	0.53	5,439	3	2	66.67
“Levica”	0.59	6,054	3	1	33.33
NMM	0.44	4,515	7	1	14.29
RBM	0.29	2,976	7	2	28.57
Të pavarur	2.41	24,731	37	7	18.92

¹⁶⁰ Në bazë të rezultateve përfundimtare të publikuara në ueb-faqen e KSHZ-së.

Zgjedhjet për kryetarë të komunave, Rrethi i parë, 15 tetor

Komuna	Numri i votuesve të regjistruar	Përqindja e daljes	LSDM		VMRO		BDI		ASH		BESA		Të pavarur		Tjetër		Të pavlefshme		
			Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura	Përqind	Vota të hedhura
Aerodrom	65,910	65.58	22,559	52.19	18,707	43.28											1,955	4.74	
Haraçinë	9,366	55.68	3,067	58.81			1,025	19.65	841	16.13	272	5.22					109	2.09	
Berovë	11,169	70.78	5,006	63.33	2,899	36.67											307	3.88	
Manastir	83,692	62.65	31,337	59.77	17,715	33.79							1,315	2.51			2,063	3.93	
Bogdanci	6,890	73.40	2,800	55.37	2,031	40.16											226	4.47	
Bogovinë	27,237	41.23					3,817	33.99	3,118	27.77	2,717	24.20			1,328	12	249	2.22	
Bosilovë	12,323	61.47	4,075	53.80	3,281	43.31											219	2.89	
Brvenicë	15,186	48.08	1,668	22.84	1,856	25.42					1,166	22.84	2,374	32.51			238	3.26	
Butell	33,275	60.97	10,063	49.60	7,845	38.67					1,172	5.78			304	1	905	4.46	
Qendra e Zhupës	6,810	35.17			648	27.06										1,688	70	59	2.46
Qendër	43,505	64.88	17,916	63.47	8,094	28.68									1,094	4	1,118	3.96	
Çair	57,767	52.72			3,441	11.30	11,860	38.95	2,327	7.64	10,202	33.50				769	3	1,610	5.29
Çashkë	6,017	66.43	1,970	49.29	931	23.29										970	24	126	3.15
Çeshinovë Obleshevë	5,704	73.00	1,938	46.54	1,977	47.48											249	5.98	
Çuçer Sandevë	7,560	63.98											2,486	51.40	2,008	42	289	5.97	
Qyteti i Shkupit	461,312	60.80	141,164	50.33	101,472	36.18			6,093	2.17	11,540	4.11				7,329	3	11,472	4.09
Dibër	18,425	46.47			685	8.00	3,419	39.93	2,597	30.33	1,271	14.84				360	4	231	2.70
Debarcë	4,625	68.06	1,785	56.70	1,212	38.50							55	1.75			96	3.05	
Delçevë	15,032	61.24	5,100	55.40	4,105	44.59											635	6.90	
Demir Hisar	7,313	78.57	3,185	55.43	2,304	40.10											257	4.47	
Demir Kapija	3,405	84.23	1,419	49.48	1,347	46.97											102	3.56	
Dojran	2,755	78.48	1,258	58.19	681	31.50							130	6.01			93	4.30	
Dolnen	11,526	58.20	1,763	26.28	1,113	16.59	2,285	34.06	124	1.85	536	7.99			217	3	250	3.73	
Gazi Babë	61,831	59.57	17,591	47.76	16,522	44.86										816	2	1,905	7.10

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Pllasnicë	4,969	49.33	945	38.56			1,449	59.12								57	2.33	
Prilep	64,985	71.14	23,607	51.07	20,917	45.25										1,705	3.69	
Probishtip	12,931	75.24	4,321	44.41	4,523	46.49								359	4	526	5.41	
Radovish	24,404	60.84	7,443	50.13	5,563	37.47						1,040	7.00			801	5.40	
Rankovc	3,096	81.59			958	37.93						1,472	58.27			96	3.80	
Resnjë	17,119	58.78	5,537	55.02	3,956	39.31										570	5.66	
Rosoman	3,411	79.48	1,338	49.35	1,241	45.78										132	4.87	
Saraj	30,942	53.35					7,963	48.24	3,191	19.33	4,582	27.76			278	494	2.99	
Shtip	42,159	68.87	13,930	47.97	13,966	48.10										1,141	3.93	
Shuto Orizare	23,289	40.51	3,763	39.88			740	7.84			513	5.44			3,593	38	710	7.53
Sopisht	4,972	69.31	1,535	44.54	1,752	50.84										163	4.73	
Nagoriçan i vjetër	3,431	62.75	955	44.36	572	26.57									554	26	72	3.34
Strugë	60,575	50.65	7,140	23.27	4,149	1352.0 0	7,916	25.80	9,289	30.27	1,060	3.45			230	1	939	3.06
Strumicë	49,318	63.11	18,502	59.45	11,751	37.76										871	2.80	
Studenicë	15,378	54.01	1,332	16.04			1,812	21.82	172	2.07	1,968	23.70			2,875	35	146	1.76
Sveti Nikollë	14,893	72.47	5,415	50.17	4,818	44.64										560	5.19	
Tearcë	22,028	44.87	708	7.16	684	6.92	2,952	29.86	1,441	14.58	2,317	23.44			1,452	15	331	3.35
Tetovë	82,887	48.23			6,459	16.16	13,265	33.18	4,874	12.19	8,767	21.93			4,568	11	2,040	5.10
Valandovë	10,125	72.75	4,074	55.31	2,734	37.12							271	3.68		287	3.90	
Vasilevë	10,451	65.66	3,604	52.52	3,046	44.39										212	3.09	
Veles	46,612	64.00	15,962	53.51	12,293	41.21									287	1	1,121	3.76
Vevçan	2,069	79.12	870	53.15	686	41.91										81	4.95	
Vinicë	17,365	60.52	5,112	48.65	4,852	46.17										545	5.19	
Vrapçisht	25,377	40.14	575	5.64			3,572	35.06	3,168	31.10	839	8.24			1,738	17	295	2.90
Zelenikovë	3,779	68.46	1,532	59.22	917	35.45										138	5.33	
Zhelinë	23,063	39.60					4,009	43.90	668	7.31	3,979	43.57			323	354	153	1.68
Zërnovc	2,628	62.06	460	28.20	791	48.50							310	19.01	27	2	43	2.64
GJITHSEJ	1,814,644	59.51	579,584		451,503		101,775		54,354		61,833		13,697		46,181		45,551	

Zgjedhjet për kryetarë të komunave, Rrethi i dytë, 29 tetor

Komuna	Numri i votuesve të regjistruar	Përqindja e daljes	LSDM		VMRO		BDI		ASH		BESA		Të pavarur		Tjetër		Të pavlefshme	
			Vota të hedhura	Per cent	Vota të hedhura	Për qind	Vota të hedhura	Për qind	Vota të hedhura	Për qind	Vota të hedhura	Për qind	Vota të hedhura	Për qind	Vota të hedhura	Për qind	Vota të hedhura	Për qind
Bogovinë	27,237	43.96					5,390	45.01	6,430	53.70							154	1.29
Brvenicë	15,186	46.03			2,949	42.19							3,871	55.38			170	2.43
Butell	33,275	52.67	9,993	57.02	7,037	40.15											496	2.83
Çair	57,767	49.50					13,916	48.66				13,707	47.93				975	3.41
Çashkë	6,017	53.81	2,253	69.58											890	27.49	94	2.90
Çeshinovë Obleshevë	5,704	75.70	2,155	49.91	1,992	46.13											171	3.96
Dibër	18,425	46.20					4,430	52.04	3,918	46.02							165	1.94
Demir Kapi	3,405	85.14	1,627	56.12	1,228	42.36											44	1.52
Dollnen	11,526	61.48	3,148	44.16			3,845	53.94									140	1.96
Gazi Babë	61,831	51.85	17,173	53.57	13,799	43.04											1,089	3.40
Gostivar	79,632	42.39					15,955	47.26	16,920	50.12							883	2.62
Gradsko	3,152	71.80	1,211	53.51	978	43.22											74	3.27
Jegunovcë	10,268	43.17	2,739	61.79	1,540	34.74											154	3.47
Karbinci	3,272	74.60	1,390	56.94	941	38.55											110	4.51
Kavadar	32,706	76.54	11,538	46.09	13,180	52.65											316	1.26
Kisella Vodë	53,090	55.61	16,207	54.89	12,277	41.58											1,041	3.53
Likovë	25,105	45.29					6,656	58.55				4,575	40.24				138	1.21
Makedonska Kamenica	6,764	73.98	2,714	54.24	2,105	42.07											185	3.70
Makedonski Brod	5,257	76.68	2,679	66.46	1,197	29.69											155	3.85
Mogillë	5,554	67.25	1,913	51.22									1,735	46.45			87	2.33
Novaci	3,079	72.49	1,183	53.00	977	43.77											72	3.23
Probishtip	12,931	76.90	5,198	52.27	4,350	43.74											397	3.99
Rosoman	3,411	82.06	1,518	54.23	1,211	43.27											70	2.50

Saraj	30,942	55.02					8,896	52.26			7,952	46.71					175	1.03
Shtip	42,159	63.39	15,078	51.54	13,363	45.68											813	2.78
Shuto Orizare	23,289	36.79	4,936	57.61										3,333	38.90		299	3.49
Nagoriçan i vjetër	3,431	61.50	1,379	65.36	670	31.75											61	2.89
Strugë	60,575	46.48					13,945	49.53	13,157	46.73							1,054	3.74
Studenican	15,378	51.87									3,737	46.85			4,161	52.17	78	0.98
Tearcë	22,028	41.19					4,686	51.64	4,170	45.96							218	2.40
Tetovë	82,887	44.57					18,136	49.09			17,113	46.32					1,697	4.59
Vinicë	17,365	61.42	5,570	52.23	4,682	43.90											413	3.87
Vrapçisht	25,377	43.38					5,184	47.09	5,642	51.25							183	1.66
Zhelinë	23,063	46.03					5,099	48.03			5,443	51.27					74	0.70
Zërnovc	2,628	62.90	670.0	40.53	944	57.11											39	2.36
GJITHSEJ	833,716	51.92	112,272		85,420		106,138		50,237		52,527		5,606		8,384		12,284	2.84

ANEKSI II: LISTA E VËZHguesVE TË MISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Kongresi i autoriteteve lokale dhe rajonale të Këshillit të Evropës

Karim	VAN OVERMEIRE	Shef i delegacionit	Belgjikë
Martine	ROUDOLFF		Austri
Renate	ZIKMUND		Austri
Marie	KAUFMANN		Republika e Çekisë
Henrik-Brade	JOHANSEN		Danimarkë
Sékolène	TAVEL		Francë
Henrietta	BERO		Hungari
Remo	GRENGA		Itali
Mario	GAUCI		Maltë
Robert	GRUMAN		Rumani
Matej	GOMBOSI		Slloveni
Kateryna	MARCHENKO		Ukrainë
Andrew	DAWSON		Mbretëria e Bashkuar

Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, Rrethi i parë

Manfred	ASCHABER		Austri
Anna-Katharina	DEININGER		Austri
Florian	DOSCHEK		Austri
Johannes	KOHLER		Austri
Thomas	MUEHLMANN		Austri
Hermann	PHILIPP		Austri
Florian	RAZESBERGER		Austri
Sigrid	STEININGER		Austri
Frederic	DE CONINCK		Belgjikë
Vessela	ATZEVA		Bullgari
Nikola	NIKOLOV		Bullgari
Ana	NIKOLOVA		Bullgari
Darab	GAJAR		Republika e Çekisë
Petra	KRATOCHVILOVA		Republika e Çekisë
Lubor	KYSUČAN		Republika e Çekisë
Václav	NEKVAPIL		Republika e Çekisë
Caroline	RISTIC		Republika e Çekisë
Pavel	TROUSIL		Republika e Çekisë
Andreas	ALSØE		Danimarkë
Hanne	BANG		Danimarkë
Grethe	BILLE		Danimarkë
Svend	HANSEN		Danimarkë
Birgit	HJORTLUND		Danimarkë
Julia	JAKOBSEN		Danimarkë
Niels Henrik	NIELSEN		Danimarkë
Karsten	POULSEN		Danimarkë
Michael	STERNBERG		Danimarkë
Lilian	PALLUM		Estoni
Timo	KOISTI		Finlandë
Sanni	KOSKI		Finlandë
Saku	LINNAMURTO		Finlandë
Peggy	CORLIN		Francë
Nadia	JURZAC		Francë
Laurent	LEMARCHAND		Francë
Salim	MEJAHDJ		Francë
Michel	RIVOLLIER		Francë
Mérodie	SAHRAIE		Francë

Claire	SCHMITT	Francë
Rüdiger Friedrich Uwe	DANAPEL	Gjermani
Thomas	DOEHNE	Gjermani
Irene	FELLMANN	Gjermani
Jens	GUZICKI	Gjermani
Ansgar	HANNOEVER	Gjermani
Maria Mechthild	HERKENHOFF	Gjermani
Michael	ICKES	Gjermani
Simon	ILSE	Gjermani
Petra	KAIFEL	Gjermani
Gudula	KILIAS	Gjermani
Rainer	KLEFFEL	Gjermani
Stefan	KOEPPE	Gjermani
Peter	KOHLMEIER	Gjermani
Wolfgang	LICHTER	Gjermani
Nikolai	LINK	Gjermani
Maik	MARTIN	Gjermani
Friedhelm	MEYER ZU NATRUP	Gjermani
Kirsten Katrin	MÜLLER	Gjermani
Dirk	NEUMEISTER	Gjermani
Susanne	NEYMEYER	Gjermani
Martin	NÖLLE	Gjermani
Tanja	POPOVIC	Gjermani
Melanie	PÖRSCHMANN	Gjermani
Heinrich	ROSENDAHL	Gjermani
Ilona	SALABA	Gjermani
Patricia	SCHERER	Gjermani
Johannes	SCHMID	Gjermani
Sabine	SMOLKA-GUNSAM	Gjermani
Hildegard	SÜHLING	Gjermani
Judith	VORRATH	Gjermani
Aron	ALBERT	Hungari
Erik	BAKTAI	Hungari
Gyozo Jozsef	GABRIEL	Hungari
Iván	KOVÁCS	Hungari
Christian	NUSSER	Hungari
David	TOTH	Hungari
Anne	CHOISEUL	Irlandë
Kevin	CRONIN	Irlandë
Padraic	MCDUNPHY	Irlandë
Raymond	MURPHY	Irlandë
Finbar	O'SULLIVAN	Irlandë
Paul	TIGHE	Irlandë
Maria Elena	AMADORI	Itali
David	CAPEZZUTO	Itali
Paolo	CARLOTTO	Itali
Luca	NUVOLI	Itali
Alessia	PAPPALARDO	Itali
Alessia	RIVA	Itali
Dana	TJURINA	Letoni
Lodewijk	BANNING	Holandë
Margriet	TEUNISSEN	Holandë
Serv	WIEMERS	Holandë
Jorun	LUNESTAD	Norvegji
Carl	PETERSEN	Norvegji
Gent	RAMADANI	Norvegji
Robert	ADAM	Rumani

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Mariam	EL-HEK	Rumani
Carmen	ILIESCU	Rumani
Peter	GOLOB	Slloveni
Lennart	HAGGREN	Suedi
Erik	LARSSON	Suedi
Hanna	NORELL	Suedi
Lena	OHRE	Suedi
Peter	WALLBERG	Suedi
Marco	BATTAGLIA	Zvicër
Martin	DAMARY	Zvicër
Evelin	HUTSON-HARTMANN	Zvicër
Francine	JOHN	Zvicër
Martin	MINDER	Zvicër
Iris	OTT	Zvicër
Anne	COTTRINGER	Mbretëria e Bashkuar
Christopher	CUNINGHAME	Mbretëria e Bashkuar
Terence	DUFFY	Mbretëria e Bashkuar
Jill	GOLDSMITH	Mbretëria e Bashkuar
Fredrick	SUMMERS	Mbretëria e Bashkuar
Mark	WALLER	Mbretëria e Bashkuar
James	WILSON	Mbretëria e Bashkuar
Karin	ACCORINTI	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Shane	AHN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Syeda	ALI	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Shaun	BARCAVAGE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
James	BERK	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Joshua	BLOOM	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jeffrey	CHINN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Cheryl	COLLINS	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kevin	CONNOLLY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Phillip	DANIEL	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Douglas	DAVIDSON	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Daniel	DRIGOT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Hedy	GLENN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andrew	GRIDINSKY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kathyrne	HARPER	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ernest	JONES	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jameson	LAMIE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Catherine	LAWRENCE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Winifred	NORTHCROSS	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Tara	O'CONNOR	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Margaret	O'SHEA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Nancy	OSBORNE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Sima	OSDOBY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Constance	PHLIPOT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ann	RANDALL	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert	RAVENSRAFT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Matthew	ROBERTS	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kathy	SCHNARE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Miklos	SOLYOM	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Angela	SWAYZE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Melinda	WALKER-STATEMAN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kira	ZAPORSKI	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, Rrethi i dytë

Manfred	ASCHABER	Austri
Philipp	HERMANN	Austri
Laura	COGELS	Belgjikë
Hanne	BANG	Danimarkë
Grethe	BILLE	Danimarkë
Svend	HANSEN	Danimarkë
Birgit	HJORTLUND	Danimarkë
Niels Henrik	NIELSEN	Danimarkë
Timo	KOISTI	Finlandë
Peggy	CORLIN	Francë
Laurent	LEMARCHAND	Francë
Gottfried	BRAMER	Gjermani
Helmut	BROCKE	Gjermani
Edgar	BRUESER	Gjermani
Jana	BÜRGERS	Gjermani
Jochen	FREDE	Gjermani
Christoph Hubert Alexander	FREIHERR VON FEILITZSCH	Gjermani
Tom	HØYEM	Gjermani
Rainer	KLEFFEL	Gjermani
Stefan	KOEPPE	Gjermani
Katleen	KRUEGER	Gjermani
Andreas	KUCHER	Gjermani
Dorothea	LUKE	Gjermani
Melanie	PÖRSCHMANN	Gjermani
Yuna	RAULT-D'INCA	Gjermani
Kerstin	ROESKE	Gjermani
Ilona	SALABA	Gjermani
Sabine	SMOLKA-GUNSAM	Gjermani
Daniel	STOCKEMER	Gjermani
Hildegard	SÜHLING	Gjermani
Volker	WEYEL	Gjermani
Aron	ALBERT	Hungari
Erik	BAKTAI	Hungari
David	TOTH	Hungari
Anne	CHOISEUL	Irlandë
Padraic	MCDUNPHY	Irlandë
Paul	TIGHE	Irlandë
Maria Elena	AMADORI	Itali
David	CAPEZZUTO	Itali
Luca	NUVOLI	Itali
Alessia	PAPPALARDO	Itali
Lodewijk	BANNING	Holandë
Margriet	TEUNISSEN	Holandë
Thomas Andreas	HUG	Norvegji
Jorun	LUNESTAD	Norvegji
Gent	RAMADANI	Norvegji
Lennart	HAGGREN	Suedi
Robert	HALL	Suedi
Erik	LARSSON	Suedi
Lennart	MYHLBACK	Suedi
Hanna	NORELL	Suedi
Lena	OHRE	Suedi
Maximo Juan	PRADES BARCELO	Suedi
Lilian	SKOGLUND	Suedi
Par	SKOLD	Suedi

Raporti përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve

Martin	DAMARY	Zvicër
Monica	GIAMBONINI	Zvicër
Pia Maria Dina	GIANINAZZI	Zvicër
Francine	JOHN	Zvicër
Martin	MINDER	Zvicër
Hans-Jürg	PFAFF	Zvicër
Anne	COTTRINGER	Mbretëria e Bashkuar
Christopher	CUNINGHAME	Mbretëria e Bashkuar
Terence	DUFFY	Mbretëria e Bashkuar
Jill	GOLDSMITH	Mbretëria e Bashkuar
Fredrick	SUMMERS	Mbretëria e Bashkuar
Mark	WALLER	Mbretëria e Bashkuar
James	WILSON	Mbretëria e Bashkuar
Syeda	ALI	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
James	BERK	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jeffrey	CHINN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Cheryl	COLLINS	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Phillip	DANIEL	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Douglas	DAVIDSON	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Daniel	DRIGOT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Hedy	GLENN	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andrew	GRIDINSKY	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kathyrne	HARPER	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Catherine	LAWRENCE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Tara	O'CONNOR	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Margaret	O'SHEA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Nancy	OSBORNE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Constance	PHLIPOT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ann	RANDALL	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert	RAVENS CRAFT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kathy	SCHNARE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Miklos	SOLYOM	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Angela	SWAYZE	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

VËZHguesIT AFATGJATË

Ekipi kryesor i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Audrey	GLOVER	Shef i Misionit	Mbretëria e Bashkuar
Mišo	IMAMOVIĆ		Bosnje dhe Hercegovinë
Vania	ANGELOVA		Bullgari
Rishi	DATTA		Kanada
Marla	MORRY		Kanada
Lela	TSASHVA		Gjeorgji
László	BELÁGYI		Hungari
Francësca	BOGGERI		Itali
Carlo	PAPPALARDO		Itali
Alessandro	ROTTA		Itali
Inta	LASE		Letoni
Angela	GHILASCU		Moldavi
Max	BADER		Holandë
Ivana	STANOJEV		Serbi
Ranko	VUKČEVIĆ		Serbi
Robert	BYSTRICKY		Slllovakia
Oliver	GREEN		Mbretëria e Bashkuar

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Margarete	LENGGER	Austri
-----------	---------	--------

Ivana	KRATKA	Republika e Çekisë
Marketa	NEKVINDOVA	Republika e Çekisë
Karen	SKIPPER	Danimarkë
Laurent	CAMPIGOTTO	Francë
Sabine	OHAYON	Francë
Kerstin	BRÖRING	Gjermani
Helmut	GÖSER	Gjermani
Wolfgang	GRAF VON SCHMETTAU	Gjermani
Pearse	MCCORLEY	Irlandë
Riccardo	ALFIERI	Itali
Rocco	DIBIASE	Itali
Rune	HAUGER	Norvegji
Stig Lennart	GLANS	Suedi
Roman	ENZLER	Zvicër
Daniele	D'ESPOSITO	Zvicër
Kiron	REID	Mbretëria e Bashkuar
Susan	TRINDER	Mbretëria e Bashkuar
Robert	BRANDSTETTER	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Karen	REINHARDT	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

PËR OSBE/ODIHR-IN

Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon vendeve anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, t'i përmbahen sundimit të ligjit, t'i promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) t'i ndërtojnë, t'i përforcojnë dhe t'i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit të vitit 1992). Ky njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar, për t'i përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ajo ka mbi 130 të punësuar.

OSBE/ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Për çdo vit, ajo e koordinon dhe e organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar se a janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me Angazhimet e OSBE-së, standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionin nacional. Metodologjia e saj unike ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, OSBE/ODIHR-i u ndihmon vendeve anëtare ta përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e **demokratizimit** përfshijnë: sundimin e të drejtës, mbështetjen ligjore, qeverisjen demokratike, emigrimin dhe lirinë e lëvizjes, dhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i për çdo vit zbaton një numër programesh të dedikuara për mbështetje, me të cilat synohet zhvillimi i strukturave demokratike.

OSBE/ODIHR-i poashtu u ndihmon vendeve anëtare t'i përmbushin obligimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e **të drejtave të njeriut** dhe lirive fundamentale që është në përputhje me përkushtimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për ta kultivuar bashkëpunimin, për t'i ndërtuar kapacitetet dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e **tolerancës** dhe të **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e OSBE/ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuar në këto fusha: legjislacioni, trajnimet për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrja, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikat e tyre që kanë të bëjnë me **romët dhe sintit**. Ajo e promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin te komuniteti rom dhe ai sinti, dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe të sinti në organet e politikë-bërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it (www.osce.org/odihr).